



# RAPORTI I PULSIT PUBLIK

# 1



**Raporti është pregaditur nga:**

UNDP Kosovë  
Njësia për Hulumtim dhe Politika

**Shkruar nga:**

Faton Bislimi  
Konsulent për Hulumtim dhe Politika  
Njësia për Hulumtim dhe Politika, UNDP Kosovë

**Kapitulli 5: Procesi i liberalizimit të vizave me BE-në**

Atdhe Hetemi  
Zyrtar i projektit Pulsi Publik  
Njësia për Hulumtim dhe Politika, UNDP Kosovë

**Analizat statistikore:**

Iris Duri  
Statisticiene  
Njësia për Hulumtim dhe Politika, UNDP Kosovë

**Redaktor të tekstit në gjuhën angleze**

Alex Standish, UNDP Kosovë dhe Jonathan Sedgwick  
Praktikant, Grupi për Përfshirje Sociale  
UNDP Kosovë

**Sigurimi i cilësisë:**

Mytaher Haskuka, PhD  
Udhëheqës i Njesisë për Hulumtim dhe Politika  
UNDP Kosovë

**Pjesëmarrësit në fokus grupe:**

Angela Mazer, UNDP Kosovë;  
Anita Smailovic, UNDP Kosovë;  
Besnik Vasolli, Këshilltar i CDF-së;  
Brikena Sylejmani, UNDP Kosovë;  
Burim Ejupi, KIPRED;  
Grodana Doric, AVENIJA;  
Jeton Mehmeti, GAP;  
Kristijan Adzic, HERC;  
Leon Malazogu, PER;  
Violeta Matovic, CPT;  
Virgjina Dumnica, UNDP Kosovë;  
Vladan Trisic, ICO;  
Vyrtyt Hasani, Ekonomist;

**Prishtinë**

Mars 2011



## Përmbatje

Parathënie.....	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	11
<b>KAPITULLI 1</b>	
Politika dhe institucionet.....	13
<b>KAPITULLI 2</b>	
Gjendja socio-ekonomike .....	19
<b>KAPITULLI 3</b>	
Marrëdhëniet ndëretnike .....	25
<b>KAPITULLI 4</b>	
Siguria dhe qetësia publike dhe personale .....	29
<b>KAPITULLI 5</b>	
Nga: Atdhe Hetemi - Procesi i liberalizimit të vizave me BE-në..	33
Vërejtjet përmbyllëse nga takimi i Fokus Grupit.....	41
Metodologjia .....	43



- EULEX** Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë
- EUSR** Përfaqësuesi Special i BE-së
- SPH** Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
- QeK** Qeveria e Kosovës
- ICO** Zyra Civile Ndërkombëtare
- ICR** Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
- PK** Policia e Kosovës
- FSK** Forca e Sigurisë e Kosovës
- LDK** Lidhja Demokratike e Kosovës
- PDK** Partia Demokratike e Kosovës
- UNDP** Programi për Zhvillim i OKB-së
- UNMIK** Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë



## Treguesit e përzgjedhur ekonomik

Column1	Jan-Mar 2005	Pri-Qer 2005	Qer-Sht 2005	Tet-Dhj 2005	Jan-Qer 2006	Qer-Sht 2006	Tet-Dhj 2006	Jan-Mar 2007	Pri-Qersh 2007	Qer-Tet 2007	Nënt-Dhj 2007	Jan-Qersh 2008	July-Sept 2008	Tet-Dhj 2008	Jan-Mar 2009	Pri-Qer 2009	Kor-Sht 2009	Jan-Mar 2010	Nënt 2010	Trend	
Popullësia (in ,000) (a)	1,999*				2,033 **			2,07**	2,07**	2,1**	2,1**	2,1**	2,1**	2,1**	2,1**	2,2*	2,2*	2,2*	2,2*	◀▶	
Norma e rritjes së BPV-së (vjetore), % (a)	0.3				3.0					3.5	3.5	3.5 (o)	3.5	3.5	5.4(a)	5.4(a)	3.8** (a)	3.8** (a)	2.9 (s)	▼	
GDP per capita, € (a)	1,120 (a)				1,117 (a)					1,150	1,150 (q)	1,150	1,150	1,150	1,784(a)	1,784(a)	1,731**(a)	1,731**(a)	1,795 (s)	▲	
KCB (Vjetor), milion € (b)	641.5				713.2 (l)			553**(m)	553 (m)	553(m)		862.13	862.13	862.13	862.13	862.13	895.9 (m)	895.9 (m)	1,461 (t)	▲	
Dërgesat e parave nga punëtorët, miliona €	281.0 (a)				318.0 (a)					398	398	467 (p)	467 (p)	387.6 (r)		535.8 (q)	535.8 (q)	535.8 (q)		◀▶	
Ndihma e huaj, miliona € (a)	462.0 *				465.0 *					352	352 (r)	275 **	275**	275**					132.4 (u)	▼	
Fondi TKPK, miliona € (c)	145.8 (Dec)				167.5 (Maj) (d)	177 (Sht) (k)	213.0 (Dhj) (k)	230.6 (Mar)		276 (Tet)		273.8 (Maj)						380.7	488.8 (Pril)	▲	
Fondi i AKM, miliona € (e)	113.1 (Dhj)				234.9 (Pr)	256.1 (Gusht) (h)	275.0 (Dhj)	291.6 (Shk)		384.4 (Tet)	399.9 (Nënt-Dhj 2007)	419.8 (Jan-Pr 2008)	426.1 (Maj)					451	463.2 March (u)	▲	
Depozitat bankare, miliona €	704.8 (Shk)	731.2 (Maj)	765.8 (Gusht)	809 (Nënt)	844.6 (Prill) (e)	881.6 (Gusht) (h)	926.4 (Dhj)	973.5 (Shkurt)	967.6 (Prill)	1,102.740 (Tet)	1,228 (Dhj) (s)	1,112 (Shku)	1,183 (p) (Maj)		1444.1 (r)	1,513 (q) (Qersh)	1,65 (q) (Sht)	1,65 (q) (Sht)	1,77 (u) (Mars)	▲	
Huat nga bankat komerciale, miliona €	356.5 (Shkurt)	400.1 (Maj)	401.8 (Gusht)	435.7 (Nënt)	459.7 (Prill) (e)	476.4 (Gusht) (h)	490.5 (Dhj)	515.1 (Shkurt)	560.2 (Prill)	659.9 (Tet)	891.2 (Dhjet) (t)	937 (Shkurt)	1,052.8 (p) (Maj)			1,281 (q) (Qersh)	1,281 (q) (Shtat)	1,281 (q) (Shtat)	1,336.2 (u) (Mars)	▲	
Bilanci tregtar, miliona € (j)	-219.1 (Jan-Mar)	-308.5 (Jan-Pr)	-723.4 (Jan-Gusht)	-1028.4 (Jan-Nënt)	-537.5 (Jan-Qer)	-761.3 (Jan-Gusht) (j)	-1235.3 (Jan-Dhjet)	-101.92 (Jan-Shk)	-400 (Jan-Prill)	-1164.2 (Jan-Tetor)	-264.6 (Nënt-Dhjet) (n)	-360 (Jan-Shku)	-142 (Maj)		-1638.5 Jan-Dhjet	-142 (Maj)		-152 (Shtat)	-152 (Shtat)	-550 Mars (u)	▼
Punëkërkuetit e regjistruar	303,095 (Jan)	311,230 (Maj)	314,446 (Gusht)	319,721 (Dhjet)	323,201 (Maj)	324,835 (Shtat)	326,026 (Dhjetor)	331,056 (Mar)			334,595 (Dhjet)	336,366 (Mar 2008) (n)	336,366 (Mar 2008) (n)		338,836 (Prill)	338,618 (Maj 2009) (q)	339,418 (Shtat 2009) (q)	339,418 (Shtat 2009) (q)	338,800 (Mars 2010) (u)	◀▶	
Indeksi i çmimit të konsumatorit, % (në krahasim me majin 2002) ***	101.4 (Maj)	100.0 (Maj)	98.5 (Gusht)	101.9 (Nënt)	102.9 (Maj)	101.3 (Gusht) (f)	102.6 (Nënt)	100.2 (Mar)	99.4 (Prill)	103.9 (Shtat)	102.8 (Dhjet)	111.4 (S hkur)	112.8 (Korrik)		110.9 (Mar)		108.8 (Shtat)	115.2 (Shtat)	119.9 Mars(u)	▲	
Pensionet bazike (për muaj), €	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40		40		70	70	70	◀▶	
Kthimet vullnetare	2,126				1,608 (g)																

\* Llogaritur

\*\* Projektuar

\*\*\* Në janar 2006, ESK ka ndryshuar metodologjinë për përpilimin e IÇK. Prandaj krahasimi i IÇK-së së prodhuar me IÇK-në para janarit 2006 nuk është i mundshëm

Burimet:

a) FMN Aide Memoire, (Shtator 2007 dhe Qer 2009);

b) MEF (2006), buxheti, MEF, Qeveria e Kosovës, Prishtinë

c) TKPK (2005), Raporti vjetor 2005, TKPK, Prishtinë

d) Vlerësimi i marrë nga TKPK përmes e-mail.

e) AQBK (2006), Buletini statistikor mujor, nr. 56, BPK, Prishtinë, Prill 2006.

f) ESK (2006), Divizioni i statistikave të çmimit, Indeksi i çmimit të konsumatorit, ESK, Qeveria e Kosovës, Prishtinë  
Shifrat tjera janë nga UNDP (2006), Raporti i paralajmërimit të hershëm nr. 12: tetor - dhjetor 2005, UNDP, Prishtinë, op. cit.

g) Komisionari i lartë i Kombeve të Bashkuara për refugjatë në Kosovë

h) BPK (2006), Buletini i statistikave mujore, nr. 56, BPK, Prishtinë, Gusht 2006.

i) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 2006.

j) Ky është deficiti tregtar për periudhën Jan-Shk 2007, Enti statistikor i Kosovës

k) Kjo shifër raportohet në faqen e TKPK-së në internet, data e botimit më 7 shkurt 2007

l) AQBK (2007). Buletini i statistikave mujore për muajin dhjetor 2006. nr (64). Prishtinë

m) Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Kosovës

n) Ministria e Shërbimeve Publike të Kosovës - buletini tremujor Maj 2008

p) AQBK - Buletini i statistikave mujore Maj 2008

q) AQBK - Buletini i statistikave mujore

r) AQBK - Raporti vjetor 2008

s) Produkti vendor gros në Kosovë 2004-2009

t) MEF (2010) Buxheti, Qeveria e Kosovës, Prishtinë

u) CBAK (2010), Buletini i statistikave mujore për mars 2010. Nr. (103). BPK Prishtinë



## Treguesit e përzgjedhur nga hulumtimi i opinionit publik

Column1	Mar 2005 a)	Sht 2005 b)	Qer 2006 c)	Dhj 2006 d)	Qer 2007 e)	Dhj 2007	Sep 2008 g)	Nov 2008 o)	Jun 2009 p)	Sep 2009 q)	Jan 2010 r)	Apr 2010 s)	Nov 2010 t)	Trend
Pesimizmi politik, % ("shumë i pakënaqur" ose "i pakënaqur" me trendët aktual politik)	38.6	41.0	43.4	48.9	54.0	41.1	36.0	35.73%	26.78%	33.03%	41.08%	37.30%	66.90%	▲
Pesimizmi ekonomik, % ("shumë i pakënaqur" ose "i pakënaqur" me trendët aktual ekonomik)	71.1	68.8	76.0	76.2	70.7	64.6	53.0	55.0	43.48%	57.07%	60.31%	53.80%	72.10%	▲
Vullneti për të protestuar për arsye ekonomike, %	62.9	57.4	62.8	42.8	54.9	71.3	68.3	75.7%	64.32%	66.58%	63.40%	59.2%	72.4%	▲
Vullneti për të protestuar për arsye politike, %	48.9	45.4	45.5	30.9	31.2	58.6	49.2	59.5%	45.21%	50.68%	46.06%	49.2%	58.7%	▲
Kënaqshmëria me punën e UNMIK-ut*, %	29.7	34.5	30.5	28.0	31.5	27.7	25.4	20.8%	28.36%	23.11%	12.58%	22.20%	18.90%	▼
Kënaqshmëria me punën e PSSP-së*, %	81.2	69.8	70.5	43.6	45.9	39.6	18.4	21.1%	33.66%	25.93%	17.79%	25.30%		
Kënaqshmëria me punën e IPVQ-së (tani Qeveria e Kosovës)*, %	81.2	48.7	43.3	27.2	35.9		49.9	55.7%	53.13%	55.83%	36.72%	29.30%	25.10%	▼
Kënaqshmëria me punën e Kuvendit të Kosovës*, %	73.7	59.0	45.4	25.6	31.9	36.7	46.0	49.0%	53.18%	46.37%	33.34%	34.10%	32.10%	◀▶
Kënaqshmëria me punën e KFOR-it*, %	81.0	84.3	81.0	77.5	81.8	83.7	84.2	86.9%	72.88%	71.90%	77.63%	69.60%	81.70%	▲
Kënaqshmëria me punën e SHPK-së*, %	86.9	84.5	81.8	72.5	79.3	78.6	80.0	80.9%	71.14%	70.96%	74.86%	74.30%	78.50%	▲
Ndjenja e pasigurisë ("paksë e pasigurt" ose "shumë i pasigurt" jashtë shtëpisë)	38.1	36.7	35.5	38.6	22.6*	55.25*	21.2	18.3	26.00%	17.87%	27.64%	29.90%	30.60%	◀▶

\* përfshinë "i kënaqur" dhe "shumë të kënaqur" (pyetja është ridizajnuar në qershor 2007, prandaj rezultatet e qershorit nuk janë të krahasueshme me rezultatet e mëhershme)

Burimet:

- UNDP, Raporti i paralajmërimit të hershëm mars 2005, UNDP, Prishtinë, op. cit.
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: sht 2005.
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: qer 2006
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: dhj 2006
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: qer 2007
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: dhj 2007
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: sht 2008
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: nën 2008
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: qer 2009
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: sht 2009
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: jan 2010
- UNDP, Hulumtimi i opinionit publik: pri 2010

Ky është botimi i parë i Raportit Pulsi Publik, vazhdimësi e Raporteve të mëparshme të Paralajmërimit të Hershëm - një seri që filloi në gusht të vitit 2002. Ne vazhdojmë të sponzorohemi nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), e cila bashkëpunon me shpenzimet e raportit. Raporti ofron analiza të vlefshme të perceptimeve të publikut, përdorur nga Kosovarët konsolidon demokracinë e saj dhe bën progres drejt forcimit të institucioneve të saj dhe qeverisjes së matur. Raport i ri Pulsi Publik tregon në një nivel më të lartë analizat nga paralajmërimi i hershëm dhe parandalimi e konflikteve, në dialogun demokratik dhe monitorimin e stabilitetit institucional. Përmes kësaj analize e cila bëhet dy herë në vit dhe debateve të ngjajshme me të shprehjet e shtojmë komunikimin në mes të institucioneve publike dhe demokratike.

Ky edicion raportit është botuar në periudhën e zhvillimeve intensive dhe të rëndësishme në lidhje me zgjedhjet kombëtare të Kosovës, krijimin e institucioneve të reja qendrore dhe përgatitjet për dialogun Prishtinë-Beograd nën patronazhin e Bashkimit Evropian. Në këtë aspekt, monitorimi i vazhdueshëm i indikatorëve të perceptimit të publikut, mund të dëshmojë të jetë një instrument i nevojshëm për të marrë informata për mendimin e popullit të Kosovës për këto procese përkatëse.

Si një risi në këtë raport kemi zhvilluar dy indekse të reja, Indeks të Demokratizimit dhe Indeks të Besimit Ekonomik. Indeksi i Demokratizimit 0,92 tregon se kosovarët vetëm pjesërisht besojnë se proceset demokratike në Kosovë janë duke shkuar në drejtimin e duhur. Ngjashëm vlera e Indeksit të Besimit Ekonomik prej 0,61 tregon se të anketuarit në përgjithësi nuk kanë një mendim të favorshëm për gjendjen ekonomike. Sfidat dhe kufizimet e institucioneve qeveritare ose publike janë të mëdha, por e tillë është edhe kërkesa e publikut dhe entuziazmi për përmirësime të dukshme në Kosovë. Disa nga pikat kryesore dhe më rëndësishme të raportit janë:

- Rezultatet e fundit të anketës Pulsi Publik tregojnë një rënie të përgjithshme të kënaqshmërisë së njerëzve me punën e institucioneve kryesore ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore të Kosovës.
- 72% e të anketuarve të të gjitha etnive duket të

jenë të pakënaqur me drejtimin ekonomik në të cilin Kosova është duke shkuar. 72% e kosovarëve duket të jenë të gatshëm dhe të kenë vullnet për t'iu bashkuar protestave publike të organizuara për shkak të arsyeve ekonomike, në krahasim me 59% e tyre që do ta bënë të njëjtën gjë për arsye politike. Sipas të dhënave të anketës, kosovarët identifikojnë papunësinë (30%) dhe varfërinë (29%), si dy problemet kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova. Problemi i tretë kryesor me të cilin ballafaqohet Kosova është korrupsioni (11%).

- Sa i përket perspektivës për normalizimin e marrëdhënieve ndëretnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, rreth një e treta e të gjithë të anketuarve besojnë se këto marrëdhënie do të normalizohen në të ardhmen e largët.
- Shqiptarët vazhdojnë të jenë shumë të kënaqur me punën e institucioneve të sigurisë në Kosovë. Në mesin e serbëve, shkalla e kënaqshmërisë me punën e institucioneve të sigurisë në Kosovë ka shënuar rritje të ndjeshme që nga prilli i vitit 2010.

Përdorimi i raportit mund të jetë me interes për lexuesit në përgjithësi, qëllimi i tij kryesor është të sigurojë një platformë të perceptimeve dhe një mekanizëm për të lehtësuar procesin e bërjes së politikave publike në demokracinë e Kosovës e cila është gjithnjë në konsolidim e sipër. Të gjitha përfundimet dhe rekomandimet e propozuara që janë paraqitur në këtë raport janë rezultat i disa raundeve të diskutimeve me ekspertë nga fusha, përvoja dhe mjediset e ndryshme institucionale.

Besojmë se analizat e paraqitura këtu do të stimulojnë shumë mendime dhe diskutime të mëtejshme në mesin e lexuesve dhe atyre me ndikim në opinionin publik në Kosovë. Prandaj, është kënaqësi e madhe për ne të shprehim mirënjohjen dhe falënderimet tona ekspertëve që kontribuan dhe morën pjesë në diskutime dhe dhanë mendime, perspektiva dhe interpretuan rezultatet e anketës, dhe për të gjithë atyre që na përkrahën në procesin e përfundimit të këtij edicioni.

Parviz Fartash  
Drejtor i UNDP-së në Kosovë

1 Për UNDP-në, të gjitha referencat për Kosovën në këtë dokument janë në kontekst të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999).



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Rezultatet e fundit të anketës Pulsi Publik tregojnë një rënie të përgjithshme të kënaqshmërisë së njerëzve me punën e institucioneve kyçe ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore të Kosovës.
- Në mes të prillit të vitit 2010 dhe nëntorit të vitit 2010, niveli i kënaqshmërisë me punën e Qeverisë së Kosovës dhe të Kryeministrit kanë rënë me rreth 4 dhe 6 pikë përqindje, përkatësisht, duke shënuar nivelet më të ulëta të tyre ndonjëherë që nga marsi i vitit 2007.
- Megjithatë, në mesin e të gjitha institucioneve, rënia më e madhe që nga prilli i vitit 2010 është rënia prej rreth 24 pikë përqindje e nivelit të kënaqshmërisë me punën e Presidentit, duke shënuar kështu nivelin më të ulët ndonjëherë me vetëm 31% të njerëzve të kënaqur me punën e tij.
- Rreth 67% e të gjithë të anketuarve janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës. Vetëm më pak se 10% duket se janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me drejtimin e tanishëm politik të Kosovës, ndërsa rreth 20% nuk janë as të kënaqur e as të pakënaqur.
- Më shumë se gjysma e të anketuarve janë të mendimit se bartësi kryesor i përgjegjësisë për situatën aktuale politike në Kosovë është Qeveria e Kosovës (54%), e pasuar nga partitë politike (17%) dhe EULEX-i (9%).
- Sipas anketës së fundit, indeksi i demokratizimit në Kosovë është 0.92, që do të thotë se shumica e njerëzve nuk ndjejnë se proceset e demokratizimit janë duke shkuar në drejtimin e duhur.
- Mesatarisht, vetëm rreth një e katërta e të gjithë të anketuarve konsiderojnë se proceset demokratike të Kosovës janë duke shkuar në drejtimin e duhur dhe janë mirë të institucionalizuara, në krahasim me pothuajse gjysmën e tyre të cilët nuk pajtohen. Megjithatë, edhe një e katërta e të anketuarve, ose nuk janë përgjigjur ose nuk kanë ndonjë mendim.
- Rreth 72% e të anketuarve të të gjitha etnive të ishin të pakënaqur me drejtimin ekonomik në të cilin është duke shkuar Kosova. Vetëm 6% e të anketuarve ishin të kënaqur me drejtimin ekonomik në të cilin është duke shkuar Kosova, ndërsa rreth 19% nuk ishin as të kënaqur e as të pakënaqur.
- Sa i përket asaj se kush mban përgjegjësinë kryesore për gjendjen ekonomike të Kosovës, 71% e të gjithë kosovarëve e vendosin këtë përgjegjësi mbi Qeverinë e Kosovës. Më pak se 9% e të anketuarve e vendosin këtë përgjegjësi mbi bashkësinë ndërkombëtare (së bashku mbi EULEX-in, ICO-në dhe UNMIK-un), dhe vetëm rreth 6% zgjedhin pushtetin lokal si përgjegjës kryesor, përderisa vetëm 2% e vendosin këtë përgjegjësi mbi komunitetin e biznesit.
- Rreth 72% e kosovarëve duken të jenë të gatshëm dhe të kenë vullnet për t'u bashkuar protestave publike të organizuara për shkak të arsyeve ekonomike, në krahasim me 59% e tyre që do të bënin të njëjtën gjë për arsye politike.
- Rreth 63% e të anketuarve presin që gjendja ekonomike të përmirësohet gjatë dy viteve të ardhshme. Megjithatë, rreth 17% besojnë se situata do të mbetet e pandryshuar, ndërsa 6% tjera besojnë se situata vetëm do të përkeqësohet gjatë dy viteve të ardhshme.
- Indeksi i përgjithshëm i besimit ekonomik i Kosovës është 0.92, që do të thotë se mesatarisht kosovarët nuk kanë qëndrim të favorshëm për ekonominë
- Sipas të dhënave të anketës, kosovarët identifikojnë papunësinë (30%) dhe varfërinë (29%), si dy problemet kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova. Problemi i tretë kryesor me të cilin ballafaqohet Kosova është korrupsioni (11%).
- Per sa i përket punësimit në sektorin publik mesatarisht 32% e kosovareve besojnë se lidhjet familjare janë faktori më i rëndësishëm pasuar prej 24% që besojnë rryshfetet janë faktori më i rëndësishëm kur një person kërkon të punësohet në sektorin publik, vetëm 12% e të anketuarve besojnë se arsimimi është i rëndësishëm, ndërsa 10% besojnë se besnikëria ndaj partisë është gjëja më e rëndësishme.
- Sa i përket mundësisë për normalizimin e marrëdhënieve ndëretnike në mes të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, rreth një e treta e të gjithë të anketuarve besojnë se këto marrëdhënie do të normalizohen në një të ardhme të largët. Rreth 18% besojnë se këto marrëdhënie do të normalizohen në të ardhmen e afërt përderisa një përqindje e njëjtë e të anketuarve beson se këto marrëdhënie nuk do të normalizohen kurrë. Vetëm 3% besojnë se marrëdhëniet ndëretnike në mes të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës tashmë janë normale.

- Rreth 46% e serbëve të Kosovës (për dallim nga 6% sa ishte në prillin e vitit 2010) do të pajtoheshin të punonin me shqiptarët. 45% (për dallim nga 6% në prillin e vitit 2010) e serbëve të Kosovës do të pajtoheshin të jetonin në të njëjtën rrugë me shqiptarët, pasuar nga 27% (për dallim nga 5% në prillin e vitit 2010) që do të pajtoheshin të jetonin në të njëjtën rrugë me shqiptarët e Kosovës.
- Shqiptarët vazhdojnë të jenë shumë të kënaqur me punë e institucioneve të sigurisë në Kosovë. Rezultatet e anketës së Pulsit Publik në nëntor të vitit 2010 tregojnë se kënaqshmëria e tyre me KFOR-in është rritur për rreth 12 pikë të përqindjes nga prilli i vitit 2010, përderisa kënaqshmëria e tyre me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Policinë e Kosovës nuk është rritur aq shumë nga prilli 2010. Niveli i kënaqshmërisë së shqiptarëve të Kosovës me policinë e EULEX-it ka pasur një rënie të vogël prej rreth 4 pikë të përqindjes nga prilli i vitit 2010.
- Në mesin e serbëve të Kosovës, kënaqshmëria me institucionet e sigurisë në Kosovë ka pasur një rritje të konsiderueshme nga prilli i vitit 2010. Në të vërtetë, kënaqshmëria e tyre me KFOR-in, Policinë e Kosovës dhe Policinë e EULEX-it ka pasur një rritje dyshifrore të pikëve të përqindjes: 18, 14, dhe 13, respektivisht, nga prilli 2010. Kënaqshmëria e tyre me FSK-në po ashtu është rritur për gjithsej 5.5 pikë të përqindjes nga prilli i vitit 2010.
- Duket se ka një rritje mjaftë të madhe nga prilli i vitit 2010 në përqindjen e të anketuarve që mendojnë se kanë qenë të diskriminuar në gjashtë muajt e fundit. Rreth 15% e shqiptarëve, 22% e serbëve dhe 32% e të anketuarve nga pakicat tjera thanë se kanë pasur situata kur ata janë ndier të diskriminuar.

# KAPITULLI 1

## Politika dhe institucionet

### **Kënaqshmëria me punën e institucioneve dhe proceset politike**

Rezultatet e fundit të anketës Pulsi Publik tregojnë një rënie të përgjithshme të nivelit të kënaqshmërisë së popullsisë me punën e institucioneve kryesore ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore të Kosovës.

Në mes të prillit të vitit 2010 dhe nëntorit të vitit 2010, nivelet e kënaqshmërisë me punën e Qeverisë së Kosovës dhe Kryeministrit kanë rënë për rreth 4 dhe 6 pikë përqindje, përkatësisht duke shënuar kështu nivelet më të ulëta që nga marsi i vitit 2007.

Nivelet e kënaqshmërisë me punën e institucioneve legjislative, siç janë Kuvendi dhe Kryetari i Kuvendit kanë rënë për rreth 2 pikë përqindje.

Megjithatë, në mesin e të gjitha institucioneve, rënia më e madhe që nga prilli i vitit 2010 është rënia prej rreth 24 pikë përqindje e nivelit të kënaqshmërisë me punën e Presidentit, duke shënuar kështu nivelin më të ulët ndonjëherë me vetëm 31% të njerëzve të kënaqur me punën e tij.

Në këtë rënie të përgjithshme të kënaqshmërisë së njerëzve me punën e institucioneve kyce të Kosovës nuk bën përjashtim as gjyqësori. Që nga prilli i vitit 2010, niveli i kënaqshmërisë me punën e gjykatave të Kosovës po ashtu ka rënë me rreth 9 pikë përqindje. Niveli i kënaqshmërisë me punën e Prokurorisë ka shënuar rënie prej rreth 12 pikë përqindje, duke e ulur atë në vetëm 15% krahasuar me 27% sa ka qenë në prill të vitit 2010.

**Tabela 1.1:** Kënaqshmëria me punën e institucioneve kryesore të Kosovës (në përqindje)

		Mar-07	Qer-07	Tet-07	Dhje-07	Maj-08	Korr-08	Tet-08	Pri-09	Qer-09	Shta-09	Jan-10	Pri-10	Nën-10
Kënaqshmëria me punën e pushtetit ekzekutiv	Qeveria	30.50%	35.99%	28.12%		46.85%	49.85%	55.71%	38.00%	53.13%	55.83%	36.72%	29.21%	25.06%
	Kryeministri	54.00%	66.00%	61.00%		72.00%	63.23%	63.12%	39.81%	53.84%	51.98%	41.50%	36.36%	30.65%
Kënaqshmëria me punën e pushtetit legjislativ	Kuvendi	31.00%	31.96%	36.19%	36.76%	51.36%	46.00%	49.03%	33.63%	53.18%	46.37%	33.34%	34.05%	32.10%
	Kryetari i Kuvendit	35.43%	33.23%	37.14%	35.10%	56.48%	43.55%	46.97%	32.77%	51.59%	49.45%	40.30%	36.03%	33.25%
	Presidenti	52.00%	64.00%	59.00%	61.00%	74.00%	68.09%	69.93%	45.66%	61.72%	60.75%	56.63%	54.88%	30.84%
Kënaqshmëria me punën e pushtetit gjyqësor	Gjykatat	20.00%	20.00%	18.00%	18.00%	21.00%	19.52%	19.71%	20.04%	32.65%	25.60%	14.73%	27.21%	18.50%
	Prokuroria	22.70%	19.79%	17.70%	18.27%	22.66%	22.79%	21.05%	20.46%	31.74%	25.74%	14.81%	26.85%	15.06%

Sipas anketës së fundit Pulsi Publik, shumica e popullsisë së Kosovës duket të jetë mjaft e shqetësuar me drejtimin politik të Kosovës. Në të vërtetë, sipas të

dhënave të studimit, rreth 67% e të gjithë të anketuarve janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës. Vetëm më pak se 10% duket se janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me drejtimin e tanishëm politik të Kosovës, ndërsa rreth 20% nuk janë as të kënaqur e as të pakënaqur.

**Tabela 1.2:** Kënaqshmëria me drejtimin politik të Kosovës, sipas përkatësisë etnike (në përqindje)

	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej të ponderuar
Shumë të kënaqur	1.9%		2.8%	1.8%
Të kënaqur	8.4%	1.4%	8.5%	7.9%
As të kënaqur, e as të pakënaqur	20.0%	8.2%	26.8%	19.7%
Të pakënaqur	31.3%	50.7%	36.6%	32.8%
Shumë të pakënaqur	35.2%	31.5%	21.1%	34.1%
Nuk e di	2.6%	5.5%	1.4%	2.7%
Nuk janë përgjigjur	.7%	2.7%	2.8%	1.0%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%


Kur u pyetën për të treguar se sipas mendimit të tyre, kush është më përgjegjës për situatën aktuale politike në Kosovë, përgjigjet e të anketuarve duket ndryshojnë nga pak varësisht nga përkatësia e tyre etnike. Për shembull, një pjesë e konsiderueshme më shumë e të anketuarve serbë dhe të pakicave tjera e konsiderojnë EULEX-in më përgjegjës për gjendjen politike në Kosovë sesa shqiptarët. Megjithatë, për çështjet tjera, të anketuarit duket se ndajnë pikëpamje të ngjashme. Mesatarisht, mbi gjysma e shqip-

tarëve (55%) dhe më shumë se 44% e serbëve dhe 45% e të anketuarve të pakicave të tjera e vënë këtë përgjegjësi mbi Qeverinë e Kosovës.

Në përgjithësi, sipas të dhënave të anketës, mbi gjysma e të anketuarve janë të mendimit se bartësi kryesor i përgjegjësisë për situatën aktuale politike në Kosovë është Qeveria e Kosovës (54%), pasuar nga partitë politike (17%) dhe EULEX-i (9%).

Për më tepër, të anketuarit u pyetën nëse ata do t'i bashkoheshin protestave publike të organizuara për shkak të arsyeve politike. Në përgjithësi, më shumë se gjysma e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa pak më shumë se një e treta e tyre nuk shpre-


**Figura 1.1:** Kush është më përgjegjës për situatën politike të Kosovës?



Sa i përket krizës së fundit politike që shpiu Kosovën drejt zgjedhjeve të jashtëzakonshme që janë mbajtur më 12 dhjetor 2010, të anketuarit duket se mënyrë të barabartë bëjnë fajtorë për shkaktimin e krizës të dy partnerët e koalicionit qeveritar, PDK-në dhe LDK-në. Rreth 30% e të anketuarve kanë fajësuar PDK-në, ndërsa rreth 28% kanë fajësuar LDK-në për shkaktimin e krizës së fundit politike në Kosovë. Megjithatë, më pak se 10% e të anketuarve kanë kritikuar opozitën dhe bashkësinë ndërkombëtare për krizën e fundit politike.


Është interesante të theksohet se përderisa për krizën e fundit politike, shqiptarët më shumë vënë fajin mbi PDK-në sesa mbi LDK-në, si të anketuarit e komunitetit serb ashtu edhe ata të pakicave tjera kanë mendim të kundërt duke vënë fajin më shumë mbi LDK-në sesa mbi PDK-në.

**Figura 1.2:** Përgjigjet në pyetjen se kush është përgjegjës për krizat e fundit politike të Kosovës.



hu gatishmërinë për t'iu bashkuar protestave të tilla publike. Në përgjithësi, sipas të dhënave të studimit, shqiptarët dhe pakicat tjera të anketuara duket se janë më shumë të gatshëm dhe kanë më shumë vullnet për t'iu bashkuar protestave politike sesa serbët.

**Figura 1.3:** Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike, sipas përkatësisë etnike (përqindja e përgjigjeve "PO")



**Tabela 1.3:** Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike, ndarja sipas aspektit urban/rural

			Ethnicity			
			K-Albanian	K-Serb	Other	Total
Urban	Readiness to join public protests due to political reasons	Yes	60.0%	48.5%	50.0%	58.6%
		No	34.5%	36.4%	42.0%	35.2%
		NA	5.5%	15.2%	8.0%	6.2%
		Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Rural	Readiness to join public protests due to political reasons	Yes	61.2%	36.6%	33.3%	58.7%
		No	35.8%	53.7%	61.9%	37.8%
		NA	3.0%	9.8%	4.8%	3.5%
		Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

**Tabela 1.4:** Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike – sipas përkatësisë gjinore

		Përkatësia etnike				
		Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej	
Meshkuj	Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike	Po	62.3%	36.1%	51.0%	60.1%
		Jo	35.4%	50.0%	44.9%	36.8%
		Pa përgjigje	2.4%	13.9%	4.1%	3.1%
		Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Femra	Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike	Po	58.8%	47.4%	31.8%	57.0%
		Jo	35.0%	42.1%	54.5%	36.2%
		Pa përgjigje	6.2%	10.5%	13.6%	6.8%
		Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Kur i ndajmë në bazë të vendbanimit të tyre, mund të shohim se mbi gjysma e të anketuarve nga mjediset urbane dhe rurale, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, do t'iu bashkoheshin protestave publike për arsye politike. Përderisa kjo ndarje nuk është e rëndësishme për shqiptarët, mund të shohim se serbët dhe minoritetet e tjera nga mjediset urbane, ndryshe nga ata që jetojnë ne

testave publike për arsye politike sesa ata të gjinisë femërore. Rreth 60% e meshkujve dhe rreth 57% e femrave të anketuara kanë shprehur gatishmërinë e tyre për t'iu bashkuar protestave të tilla. Megjithatë, në rastin e serbëve më shumë femra (47%) sesa meshkuj (36%) janë të gatshëm t'iu bashkohen protestave publike për shkak të arsyeve politike.

**Tabela 1.5:** Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike – sipas rajonit

Rajoni		Përkatësia etnike				
		Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej	
Prishtina	Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike	Po	56.9%	52.2%	33.3%	55.4%
		Jo	39.7%	39.1%	66.7%	41.1%
		Pa përgjigje	3.4%	8.7%	.0%	3.6%
		Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Mitrovica	Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike	Po	59.6%	47.1%	33.3%	56.3%
		Jo	30.1%	41.2%	50.0%	33.0%
		Pa përgjigje	10.3%	11.8%	16.7%	10.8%
		Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Prizren	Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike	Po	61.0%	.%	46.4%	59.5%
		Jo	33.9%		42.9%	34.8%
		Pa përgjigje	5.1%		10.7%	5.7%
		Gjithsej	100.0%	.%	100.0%	100.0%
Peja	Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike	Po	70.5%		50.0%	69.4%
		Jo	27.5%		37.5%	28.0%
		Pa përgjigje	2.0%		12.5%	2.5%
		Gjithsej	100.0%		100.0%	100.0%
Ferizaj	Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike	Po	48.9%	25.0%	100.0%	48.6%
		Jo	45.9%	75.0%	.0%	46.4%
		Pa përgjigje	5.2%			5.0%
		Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Gjakova	Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike	Po	68.0%		71.4%	68.3%
		Jo	30.7%		28.6%	30.5%
		Pa përgjigje	1.3%			1.2%
		Gjithsej	100.0%		100.0%	100.0%
Gjilan	Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve politike	Po	68.8%	20.0%	50.0%	61.9%
		Jo	31.3%	60.0%	50.0%	35.4%
		Pa përgjigje		20.0%	.0%	2.7%
		Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

zona rurale janë më të gatshëm t'iu bashkohen protestave të tilla.

Rezultatet e anketës po ashtu tregojnë se, pavarësisht nga përkatësia etnike, të anketuarit e gjinisë mashkullore janë më të gatshëm t'iu bashkohen pro-

Kur të dhënat e njëjta të ndahen sipas rajoneve atëherë Peja (69%), Gjakova (68%) dhe Gjilani (62%) dalin se janë tre rajonet me numrin më të lartë të anketuarve të cilët shprehën dëshirën e tyre për të protestuar për arsye politike. Megjithatë, tre rajonet me numrin më të madh të atyre që nuk janë të gatshëm të protestojnë janë Ferizaj (46%), Prishtina (41%) dhe Gjilani (35%).



**Demokratizimi dhe pjesëmarrja publike** në jetën politike dhe qytetare. Indeksi i demokratizimit është llogaritur duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën 1.4. Indeksi i demokratizimit i cili mund të jetë prej 0 deri në 3 është i dizajnuar për qëllim të matjes së perceptimeve të kosovarëve për çështjet që kanë të bëjnë me proceset e demokratizimit. Një indeks i demokratizimit nën 1,5 pikë paraqet vlerësimin se kosovarët nuk e perceptojnë se proceset e demokratizimit po shkojnë në drejtimin e duhur, në mënyrë specifike më shumë të anketuar kanë mendime negative për procesin demokratik sesa vlerësim pozitiv. Në anën tjetër, indeksi i demokratizimit më i lartë se 1.5 pikë do të thotë se perceptimet për demokratizimin në përgjithësi janë pozitive, më shumë të anketuar besojnë se proceset demokratike janë duke shkuar në drejtimin e duhur.

Sipas anketës së fundit, indeksi i demokratizimit në Kosovë është 0.92, që do të thotë se shumica e njerëzve

**Tabela 1.4:** Mesatarja e përbërjes së indeksit të demokratizimit

	A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	A e monitoron Kuvendi performancën e Qeverisë?	A është sistemi gjyqësor në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	A e gëzojnë mediat në Kosovë lirinë e shprehjes?	A shërben shoqëria civile në Kosovë si monitorues i vërtet i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	A është pushteti i juaj lokal (komunal) duke punuar në pajtim me prioritetet e qytetarëve të Kosovës?	A është qeveria e Kosovës duke punuar në pajtim me prioritetet e qytetarëve të Kosovës?	A janë demokratike Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi dhe a i respektojnë ato të drejtat e njeriut?
Mesatarja	1.04	0.91	0.60	1.10	0.95	1.01	0.59	1.08

nuk e perceptojnë se proceset e demokratizimit janë duke shkuar në drejtimin e duhur.

Ngjashëm me indeksin e demokratizimit, duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën 1.5, është llogaritur edhe indeksi i pjesëmarrjes për Kosovën. Indeksi i pjesëmarrjes që mund të jetë në mes të 0 dhe 3 mat nivelin e pjesëmarrjes së popullsisë në jetën politike dhe qytetare të Kosovës. Një indeks i pjesëmarrjes 0 do të nënkuptonte se nuk ka pjesëmarrje publike në jetën politike dhe qytetare të Kosovës, ndërsa indeks i pjesëmarrjes 3 do të nënkuptonte se ka pjesëmarrje të plotë publike në jetën politike dhe qytetare të Kosovës.

Megjithatë, sipas anketës së fundit, indeksi i pjesëmarrjes së Kosovës është 0,24, që do të thotë se pjesëmarrjen e publikut në jetën politike dhe qytetare të Kosovës është shumë e ulët. Në të vërtetë, kur të ndahen sipas gjinisë, indeksi mesatar i pjesëmarrjes duket se është pak më i lartë për meshkujt (0,27) sesa për femrat (0,21).

**Tabela 1.3:** Indeksat e demokratizimit dhe pjesëmarrjes


	Min	Max	Mesatarja e Kosovës
Indeksi i demokratizimit	0	3	0.92
Indeksi i demokratizimit (meshkuj)	0	3	0.94
Indeksi i demokratizimit (femra)	0	3	0.89
Indeksi i pjesëmarrjes	0	3	0.24
Indeksi i pjesëmarrjes (meshkuj)	0	3	0.27
Indeksi i pjesëmarrjes (femra)	0	3	0.21

Indeksi i demokratizimit përbëhet siç është paraqitur në tabelën vijuese:

Disa indikator të demokratizimit për të cilët anketa Pulsi Publik ka mbledhur të dhëna tregojnë se vetëm rreth një e treta e kosovarëve besojnë se Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në Kosovë janë demokratike dhe respektojnë të drejtat e njeriut, që pushtetet komunale punojnë në bazë të prioritetëve të banorëve të tyre, që media gëzon lirinë e shprehjes dhe se zgjedhjet janë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Për më tepër, një pjesë shumë e vogël e kosovarëve, rreth 15% e tyre, besojnë se Qeveria e Kosovës punon në përputhje me prioritetet e kosovarëve dhe se gjyqësori i Kosovës është i pavarur në vendimmarrje.

**Figura 1.4:** Përqindja e përgjigjeve pozitive në pyetjet e indeksit të demokratizimit (përqindja e përgjigjeve të cilët "pajtohen plotësisht ose kryesisht")




Megjithatë, rreth 27% e kosovarëve besojnë se shoqëria civile e Kosovës shërben si një monitorues i sigurtë i zhvillimeve demokratike në Kosovë dhe se Parlamenti i Kosovës me të vërtetë e monitoron performancën e Qeverisë së Kosovës.

Në përpjekje për të matur pjesëmarrjen publike në jetën politike dhe qytetare të Kosovës, anketa Pulsi Publik ka kërkuar nga të anketuarit t'i përgjigjen pyetjeve në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në aktivitete që konsiderohen publike, politike ose qytetare brenda gjashtë muajve të fundit.

Pjesëmarrja në aktivitetet e një partie politike (15,50%) rezultoi të jetë mënyra më e popullarizuar e pjesëmarrjes në jetën politike të Kosovës dhe/ose në jetën qytetare. Kjo është për së afërmi e pasuar nga pjesëmarrja në diskutime publike (15%), si dhe pjesëmarrja në një OJQ (13%), iniciativë qytetare dhe projekte të zbatuara nga pushteti lokal (secila me nga 11%).

Megjithatë, vetëm rreth 5% e të anketuarve kanë treguar për pjesëmarrjen e tyre në projekte të zbatuara nga qeveria qendrore.

**Figura 1.5:** Përgjigjet afirmative në pyetjet e ndërlidhura me pjesëmarrje gjatë gjashtë muajve të fundit (përqindja e përgjigjeve për pjesëmarrje aktive ose joaktive)




Duke pasur parasysh faktin se anketa është realizuar gjatë një viti kur ka pasur zgjedhje, të anketuarit janë pyetur nëse ata besonin që vota e tyre mund të ndryshojë realisht gjendjen në Kosovë.

Rezultatet e anketës tregojnë se rreth gjysma e shqiptarëve së bashku me 40% e të anketuarve të pakicave

të tjera, si dhe rreth 5% e serbëve besojnë se vota e tyre mundet që realisht të ndryshojë situatën në Kosovë. Megjithatë, rreth 31% e shqiptarëve së bashku me rreth 62% e serbëve, si dhe rreth 37% e të anketuarve të pakicave të tjera kanë mendim të kundërt.

Mesatarisht, rreth 46% në krahasim me rreth 33% e kosovarëve në përgjithësi besojnë se votat e tyre mundet realisht të ndryshojë situatën në Kosovë. Rreth 21% e kosovarëve nuk kanë asnjë përgjigje ose nuk e dinë nëse votat e tyre mund të ndryshojë ndonjë gjë në të vërtetë..

**Figura 1.6:** A do të ndryshojë vota juaj situatën në Kosovë, sipas përkatësisë etnike (në përqindje)



Së fundi, të anketuarit janë pyetur për pritjet e tyre në lidhje me drejtimin dhe institucionalizimin e proceseve demokratike të Kosovës si një shoqëri në tranzicion. Rreth 27% e shqiptarëve së bashku me 34% e të anketuarve të pakicave të tjera, si dhe vetëm 1% e serbëve besojnë se proceset demokratike janë drejtuar në drejtimin e duhur dhe janë mirë të institucionalizuara. Megjithatë, rreth 48% e shqiptarëve së bashku me shumicën dërrmuese të serbëve (77%) dhe 37% e të anketuarve të pakicave të tjera kanë mendim të kundërt.

Mesatarisht, vetëm rreth një e katërta e të gjithë të anketuarve konsiderojnë se proceset demokratike të Kosovës janë duke shkuar në drejtimin e duhur dhe janë mirë të institucionalizuara, në krahasim me pothuajse gjysmën e tyre të cilët nuk pajtohen. Megjithatë, edhe një e katërta e të anketuarve, ose uk janë përgjigjur ose nuk kanë ndonjë mendim.

**Tabela 1.8:** Pikëpamjet për drejtimin dhe institucionalizimin e proceseve demokratike, sipas përkatësisë etnike

Pavarësisht politikës ditore dhe duke shikuar kah e ardhmja, a pajtoheni se proceset demokratike në Kosovë janë institucionalizuar dhe janë duke shkuar drejt drejtimin e duhur?	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej të ponderuar
Po	26.6%	1.4%	34.3%	25.6%
Jo	48.4%	76.7%	37.1%	49.4%
Nuk e di	21.9%	15.1%	22.9%	21.5%
Pa përgjigje	3.1%	6.8%	5.7%	3.5%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%



## KAPITULLI 2

### Gjendja socio-ekonomike

#### Kënaqshmëria dhe pritjet për ekonominë

**Tabela 2.1:** Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës

	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej të ponderuar
Të kënaqur	6.5%	1.4%	8.3%	6.3%
Të pakënaqur	71.9%	80.8%	66.7%	72.1%


Ngjashëm me kënaqshmërinë në drejtimin politik të cilin Kosova është duke e ndjekur aktualisht, 72% e të anketuarve të të gjitha etnive ishin të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Vetëm 6% e të anketuarve ishin të kënaqur me drejtimin ekonomik në të cilin Kosova është duke shkuar, ndërsa rreth 19% nuk ishin as të kënaqur e as të pakënaqur.

**Tabela 2.2:** Kush është më së shumti përgjegjës për gjendjen ekonomike të Kosovës, sipas përkatësisë etnike?

	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej të ponderuar
EULEX-i	4.8%	8.1%	9.7%	5.3%
ICO-ja	1.1%		1.4%	1.0%
UNMIK-u	2.5%	6.8%	4.2%	2.8%
Qeveria e Kosovës	72.7%	54.1%	58.3%	70.8%
Pushtetet lokale	5.8%	6.8%	4.2%	5.7%
Komuniteti afarist	2.0%	2.7%	5.6%	2.2%
Tjera	2.5%	6.8%	1.4%	2.7%
Nuk e di	8.1%	12.2%	12.5%	8.6%
Pa përgjigje	0.6%	2.7%	2.8%	0.9%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Sa i përket asaj se kush mban përgjegjësinë kryesore për gjendjen ekonomike të Kosovës, 71% e të gjithë kosovarëve e vendosin këtë përgjegjësi mbi Qeverinë

**Figura 2.1:** Përqindja e të anketuarve të gatshëm për t'iu bashkuar protestave për shkak të arsyeve ekonomike, sipas përkatësisë etnike



e Kosovës. Më pak se 9% e të anketuarve e vendosin këtë përgjegjësi mbi bashkësinë ndërkombëtare (së bashku mbi EULEX-in, ICO-në dhe UNMIK-un), 6% zgjedhin pushtetin lokal si përgjegjës kryesor dhe vetëm 2% e vendosin këtë përgjegjësi mbi komunitetin e biznesit.

**Tabela 2.3:** Përqindja e të anketuarve të gatshëm për t'iu bashkuar protestave për shkak të arsyeve ekonomike – sipas ndarjes në mjedis urban/rural

		Përkatësia etnike			
		Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Urban	Po do t'iu bashkohem protestave publike	79.2%	50.0%	66.0%	76.8%
	Jo nuk do t'iu bashkohem protestave publike	20.8%	50.0%	34.0%	23.2%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Rural	Po do t'iu bashkohem protestave publike	75.8%	41.0%	52.6%	72.9%
	Jo nuk do t'iu bashkohem protestave publike	24.2%	59.0%	47.4%	27.1%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Kur është fjala për t'iu bashkuar protestave publike për shkak të arsyeve ekonomike, përqindja e atyre që dëshirojnë për ta bërë këtë është më e lartë sesa e atyre që dëshirojnë t'iu bashkohem protestave politike. 72% e kosovarëve duken të jenë të gatshëm dhe të kenë vullnet për t'iu bashkuar protestave publike të organizuara për shkak të arsyeve ekonomike, në krahasim me 59% e tyre që do të bënin të njëjtën gjë për arsye politike. Edhe një herë, sikurse me protestat politike, serbët tregojnë përqindjen më e ulët në mesin e të gjitha etnive të atyre që dëshirojnë t'iu bashkohem protestave ekonomike.

Për më tepër, pas zbrërthimit të të dhënave, rezultatet e anketës tregojnë se mesatarisht rreth 77% e atyre që jetojnë në një mjedis urbane në krahasim me 73% të atyre që

ekonomike. Edhe pse në rastin e serbëve ka më shumë femra (51,5%) sesa meshkuj (36%) të cilët do t'iu bashkoheshin protestave të tilla.

**Tabela 2.4:** Përqindja e të anketuarve të gatshëm për t'iu bashkuar protestave për shkak të arsyeve ekonomike – sipas përkatësisë gjinore

		Përkatësia etnike			
		Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Meshkuj	Po do t'i bashkohem protestave publike	79.5%	36.4%	66.0%	76.4%
	Jo nuk do t'i bashkohem protestave publike	20.5%	63.6%	34.0%	23.6%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Femra	Po do t'i bashkohem protestave publike	75.0%	51.5%	52.6%	72.9%
	Jo nuk do t'i bashkohem protestave publike	25.0%	48.5%	47.4%	27.1%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

jetojnë në një mjedis rural janë të gatshëm të protestojnë për arsye ekonomike, pavarësisht përkatësisë etnike.


Megjithatë, sipas gjinisë, tek të gjitha përkatësitë etnike meshkujt (76%) më shumë sesa femrat (73%) janë të gatshëm t'iu bashkohem protestave publike për arsye

Pas zbrërthimit të të dhënave sipas rajonit, rezultatet e anketës tregojnë se rajonet me numrin më të madh të atyre të gatshëm të protestojnë për arsye ekonomike janë Peja (81%), Gjakova (80,5%) dhe Prizreni e Prishtina (77%).

**Tabela 2.5:** Gatishmëria për t'iu bashkuar protestave për shkak të arsyeve ekonomike – sipas rajonit

		Përkatësia etnike			
		Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Prishtina	Po do t'i bashkohem protestave publike	79.8%	52.4%	55.6%	76.7%
	Jo nuk do t'i bashkohem protestave publike	20.2%	47.6%	44.4%	23.3%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Mitrovica	Po do t'i bashkohem protestave publike	72.3%	48.4%	40.0%	66.9%
	Jo nuk do t'i bashkohem protestave publike	27.7%	51.6%	60.0%	33.1%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Prizren	Po do t'i bashkohem protestave publike	78.2%		65.4%	76.9%
	Jo nuk do t'i bashkohem protestave publike	21.8%		34.6%	23.1%
	Gjithsej	100.0%		100.0%	100.0%
Peja	Po do t'i bashkohem protestave publike	82.3%		62.5%	81.3%
	Jo nuk do t'i bashkohem protestave publike	17.7%		37.5%	18.7%
	Gjithsej	100.0%		100.0%	100.0%
Ferizaj	Po do t'i bashkohem protestave publike	68.3%	25.0%	100.0%	67.4%
	Jo nuk do t'i bashkohem protestave publike	31.7%	75.0%		32.6%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Gjakova	Po do t'i bashkohem protestave publike	81.3%		71.4%	80.5%
	Jo nuk do t'i bashkohem protestave publike	18.7%		28.6%	19.5%
	Gjithsej	100.0%		100.0%	100.0%
Gjilan	Po do t'i bashkohem protestave publike	76.8%	25.0%	50.0%	70.6%
	Jo nuk do t'i bashkohem protestave publike	23.2%	75.0%	50.0%	29.4%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%


**Figura 2.2:** Pritjet për gjendjen ekonomike gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, sipas përkatësisë etnike



Në anën tjetër, tre rajonet me numrin më të vogël të atyre të gatshëm të protestojnë për arsye ekonomike janë të Ferizaj dhe Mitrovica (67%) dhe Gjilani (71%). Por, çfarë janë pritjet e kosovarëve për sa i përket perspektivës ekonomike? Brenda një periudhe afatshkurtër (p.sh. gjatë gjashtë muajve të ardhshëm), pothuajse gjysma e kosovarëve besojnë se gjërat nuk do të ndryshojë. Megjithatë, një e treta prej tyre kanë një qëndrim pozitiv dhe besojnë se gjendja ekonomike e Kosovës do të përmirësohet gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, ndërsa rreth 10% besojnë se situata vetëm sa do të përkeqësohet.

Brenda një periudhe më afatgjate, pikërisht gjatë dy viteve të ardhshme, kosovarët duket të kenë pritje optimiste. 63% e të anketuarve presin që gjendja ekonomike të përmirësohet gjatë dy viteve të ardhshme. Megjithatë, rreth 17% besojnë se situata do të mbetet e pandryshuar, ndërsa 6% tjera besojnë se situata vetëm do të përkeqësohet gjatë dy viteve të ardhshme. Qoftë brenda një periudhe afatshkurtër apo afatgjatë, serbët duket të jenë grupi etnik me shkallën më të ulët të optimizmit në lidhje me gjendjen ekonomike të Kosovës, duke pasur përqindjen më të ulët të atyre që besojnë se gjërat do të bëhen më mirë.

**Figura 2.3:** Pritjet për gjendjen ekonomike gjatë dy viteve të ardhshme



Siç janë llogaritur indekset e demokratizimit dhe pjesëmarrjes në Kapitullin 1, është llogaritur edhe indeksi i besueshmërisë ekonomike të Kosovës, në bazë të dhënave të paraqitura në figurën 2.4. Indeksi i besueshmërisë ekonomike mund të jetë prej 0 deri në 3; indeksi prej 0-1,5 nënkupton se shumica e kosovarëve nuk kanë besim në ekonomi. Në anën tjetër, indeksi 1,5 dhe më i lartë do të thotë se shumica e kosovarëve kanë besim në ekonomi, ndërsa indeks 3 nënkupton se të gjithë kosovarët kanë besim në ekonomi.

**Tabela 2.6:** Indeksi i besueshmërisë ekonomike


	Min	Max	Mesatarja e Kosovës
Indeksi i besueshmërisë ekonomike	0	3	0.92
Indeksi i besueshmërisë ekonomike (meshkuj)	0	3	0.85
Indeksi i besueshmërisë ekonomike (femra)	0	3	0.99

Duke u bazuar në të dhënat e anketës Pulsi Publik, indeksi i përgjithshëm i besimit në ekonomi në Kosovë është 0.92, që do të thotë se mesatarisht kosovarët nuk kanë qëndrim të favorshëm për ekonominë.

Indikatorët e besueshmërisë ekonomike që janë matur në anketë kanë përfshirë pritjet e popullsisë për kushtet e punësimit brenda një periudhe afatshkurtër (që është elaboruar në hollësi në pjesën tjetër të këtij kapitulli), vlerësimin e tyre për kushtet aktuale për biznes si dhe pritjet e tyre për të ardhurat e përgjithshme të familjeve të tyre në të ardhmen e afërt.

Rreth 18% e të anketuarve shprehën pritje të favorshme për të ardhurat e familjeve të tyre në të ardhmen e afërt, ndërsa rreth 15% konsiderojnë të favorshme kushtet për punësimin e tyre në të ardhmen. Megjithatë, vetëm 4% e të anketuarve, kishte një qëndrim të favorshëm për kushtet aktuale për punësim së bashku me rreth 12,5%, të cilët kishin qëndrim të favorshëm për kushtet aktuale për biznes.

**Figura 2.4:** Indikatorët e besueshmërisë ekonomike (% e të anketuarve që kanë deklaruar "të favorshme")



### **Punësimi dhe perceptimet e korrupsionit në shkallë të gjerë**

Sipas të dhënave të anketës, kosovarët identifikojnë papunësinë (e përzgjedhur nga 30% e të anketuarve) dhe varfërinë (29%), si dy problemet kryesore me të

cilat ballafaqohet Kosova. Duke pasur parasysh këtë, punësimi duket të jetë një mënyrë shumë e rëndësishme për t'iu mundësuar kosovarëve të ecin përpara.

Në lidhje me atë se cilat nga institucionet e mëposhtme zbatojnë rekrutimin në mënyrë të drejtë, sektori privat (21%), pasuar nga organizatat ndërkombëtare (11%) dhe në komunat (8%) besohet të jenë tre institucionet kryesore që zbatojnë rekrutimin e drejtë. Vetëm 4% e të anketuarve besojnë se Qeveria e Kosovës dhe sektori publik (KEK-u, PTK-ja, etj) zbatojnë rekrutim të drejtë me rastin e punësimit të punonjësve të rinj.


**Tabela 2.4:** Rekrutimi i drejtë në institucionet/subjektet e caktuara, sipas përkatësisë etnike

	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej të ponderuar
Komunat	7.6%	11.0%	8.5%	7.9%
Qeveria	4.6%	0.0%	4.2%	4.3%
Sektori publik (KEK-u, PTK-ja, etj.)	4.3%	5.5%	2.8%	4.3%
Sektori privat	21.3%	16.4%	16.9%	20.8%
Organizatrat ndërkombëtare	10.3%	11.0%	25.4%	11.2%
OJQ-të	6.7%	9.6%	5.6%	6.8%
Nuk e di	33.9%	28.8%	25.4%	33.1%
Nuk janë përgjigjur	11.3%	17.8%	11.3%	11.7%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Megjithatë, të dhënat e studimit na japin disa rezultate shqetësuese sa i përket asaj se çfarë është më e rëndësishme kur një person kërkon të punësohet në sektorin publik. Mesatarisht, 32% e kosovarëve besojnë se lidhjet familjare janë faktori më i rëndësishëm, pas kësaj 24% besojnë se ryshfetet janë faktori më i rëndësishëm për të shtuar mundësitë e punësimit në sektorin publik. Vetëm 12% e të anketuarve besojnë se arsimimi është i rëndësishëm kur një person kërkon të punësohet në sektorin publik, ndërsa 10% besojnë se besnikëria ndaj partisë është gjëja më e rëndësishme.

Nëse këta faktorë do të grupoheshin në dy kategori


**Figura 2.5:** Rëndësia e faktorëve që ndikojnë në mundësitë e punësimit në sektorin publik (% e të anketuarve të cilët kanë vlerësuar secilin faktor si më të rëndësishmin)




- Përvoja profesionale
- Arsimimi
- Aftësimet profesionale
- Ryshfeti
- Lidhjet familjare
- Bindja partiake
- Pamja (veshja, makijazhi)
- Shokët
- Gjinia
- Nuk e di / Pa përgjigje

– atyre që kërkohen përmes rregullave dhe rregulloreve dhe kategorinë e atyre që konsiderohen se janë të paligjshme ose në kundërshtim me rregullat dhe rregulloret - të dhënat e anketës tregojnë se 71% e të anketuarve i konsiderojnë faktorët e paligjshëm më të rëndësishëm sesa ata ligjorë (21%), për të fituar një vend pune në sektorin publik.

**Figura 2.6:** Rëndësia e faktorëve që ndikojnë në shanset e punësimit në sektorin publik - ligjore/joligjore (në përqindje)



**Figura 2.8:** Kushtëzimi i kryerjes së shërbimeve nga ana e zyrtarëve publik me ryshfete, dhurata dhe favore tjera



Sipas të dhënave të studimit, problemi i tretë më i madh me të cilin përballet Kosova, pas papunësisë (30%) dhe varfërisë (29%), është korrupsioni (11%). Sa i përket perceptimit të popullsisë për shkallën e lartë të korrupsionit, KEK-u, AKP-ja (Agjencia Kosovare e Privatizimit) dhe gjykatat janë tri institucionet kryesore me perceptimin më të lartë publik për korrupsion në shkallë të madhe. Institucionet me perceptimin më të ulët publik për korrupsion janë bankat, sektori i arsimit dhe OJQ-të.

**Figura 2.7:** Perceptimet për korrupsionin në shkallë të lartë



Kur të anketuarit u pyetën nëse në gjashtë muajt e fundit ata ishin në një situatë ku zyrtarët publikë ua kanë kushtëzuar kryerjen e shërbimeve duke kërkuar ryshfet, dhurata dhe favore të tjera, 15% e të anketuarve kanë konfirmuar një situatë të tillë të kushtëzimit; në këtë drejtim "pakicat e tjera" kanë raportuar shkallën më të lartë të kushtëzimit (21%), ndërsa serbët shkallën më të ulët të kushtëzimit (7%).






## KAPITULLI 3

### Marrëdhëniet ndëretnike


**Figura 3.1:** Mundësitë për normalizimin e marrëdhënieve ndëretnike



Marrëdhëniet ndëretnike vazhdojnë të mbesin një për-caktues i rëndësishëm i rrugëtimit të Kosovës drejt së ardhmes. Ndonëse ende ka tensione në mes të grupeve të ndryshme etnike në Kosovë, po ashtu ka edhe shenja se

megjithatë, nuk tregojnë ndonjë ndryshim të madh të opinionit të shqiptarëve të Kosovës për këtë çështje. Për serbët e Kosovës, megjithatë, ky tregues ka rënë për rreth 17 pikë të përqindjes që nga muaji prill i vitit 2010.

**Figura 3.2:** Përqindja e të anketuarve që konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara dhe nuk janë duke u përmirësuar



këto marrëdhënie do të normalizohen. Kështu, sa i përket mundësisë për normalizimin e marrëdhënieve ndëretnike në mes të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, rreth një e treta e të gjithë të anketuarve besojnë se këto marrëdhënie do të normalizohen në një të ardhme të largët. Rreth 18% besojnë se këto marrëdhënie do të normalizohen në të ardhmen e afërt përderisa një përqindje e njëjtë e të anketuarve beson se këto marrëdhënie nuk do të normalizohen kurrë. Vetëm 3% besojnë se marrëdhëniet ndëretnike në mes të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës tashmë janë normale.

Rezultatet e matjes së Pulsit Publik në nëntor të vitit 2010 tregojnë se ka një rënie të vogël të numrit të serbëve të Kosovës që besojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara dhe nuk janë duke u përmirësuar. Të dhënat,

Kur ndahen sipas llojit të banimit të tyre, 20% e të anketuarve që mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara dhe nuk janë duke u përmirësuar janë nga mjediset urbane dhe 20% nga mjediset rurale. Prej të anketuarve që mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë normale (nuk janë aspak të tensionuara), 14% janë nga mjediset urbane përderisa 14% të tjerë janë nga mjediset rurale.

Kur ndahen sipas ndarjes rurale/urbane, të dhënat për marrëdhëniet e perceptuara etnike nuk kanë vënë në pah ndonjë dallim të madh. Kjo dëshmohet nga fakti se si për të anketuarit në zonat rurale ashtu edhe për ata në zonat urbane, rreth 20% mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara dhe nuk ka përmirësime dhe 14% mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike tashmë janë normale.

**Tabela 3.1:** Vlerësimi i marrëdhënieve ndëretnike sipas ndarjes rurale/ urbane

		Përkatësia etnike			
		Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Urbane	Marrëdhëniet janë të tensionuara dhe do vazhdojnë të jenë të tilla	17.1%	61.3%	21.6%	19.6%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por kohëve të fundit ka disa përmirësime	26.3%	19.4%	33.3%	26.5%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por janë shënuar përmirësime të konsiderueshme	20.9%	3.2%	13.7%	19.4%
	Marrëdhëniet janë shumë të tensionuara	8.7%	3.2%	9.8%	8.5%
	Marrëdhëniet nuk janë aspak të tensionuara	15.2%	.0%	7.8%	13.9%
	Nuk e di	10.5%	9.7%	11.8%	10.6%
	Nuk ka përgjigje	1.3%	3.2%	2.0%	1.4%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Rurale	Marrëdhëniet janë të tensionuara dhe do vazhdojnë të jenë të tilla	18.3%	43.9%	9.5%	19.7%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por kohëve të fundit ka disa përmirësime	31.7%	17.1%	14.3%	30.2%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por janë shënuar përmirësime të konsiderueshme	12.5%	12.2%	9.5%	12.4%
	Marrëdhëniet janë shumë të tensionuara	10.8%	9.8%	14.3%	10.8%
	Marrëdhëniet nuk janë aspak të tensionuara	14.6%	.0%	23.8%	14.0%
	Nuk e di	10.3%	9.8%	19.0%	10.5%
	Nuk ka përgjigje	1.7%	7.3%	9.5%	2.4%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Kur ndahet sipas grupmoshës, hulumtimi tregon se prej të anketuarve që mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara dhe nuk janë duke u përmirësuar, pothuajse gjysma (46%) janë nga grupmoshat e reja dhe ato të mesme (18-24 dhe 31-36). Ndërsa, prej të anketuarve që mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë normale, më pak se një e treta (29%) janë nga grupmosha më e re dhe ajo më e vjetër.

Rezultatet e matjes së Pulsit Publik në nëntor të vitit 2010, sikurse hulumtimeve të mëhershme të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, e konfirmojnë se arsyet që janë dhënë për mungesën e përmirësimit të marrëdhënieve të tensionuara ndëretnike, veçanërisht të atyre në mes të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, vazhdojnë të dallojnë varësisht prej përkatësisë etnike.

**Tabela 3.2:** Vlerësimi i marrëdhënieve ndëretnike sipas grupmoshës


grup moshat		Përkatësia etnike			
		Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
18-24	Marrëdhëniet janë të tensionuara dhe do vazhdojnë të jenë të tilla	22.9%	37.5%	17.6%	23.4%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por kohëve të fundit ka disa përmirësime	25.2%	18.8%	35.3%	25.4%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por janë shënuar përmirësime të konsiderueshme	16.7%	.0%	11.8%	15.5%
	Marrëdhëniet janë shumë të tensionuara	8.9%	18.8%	5.9%	9.3%
	Marrëdhëniet nuk janë aspak të tensionuara	13.6%		5.9%	12.4%
	Nuk e di	11.2%	25.0%	11.8%	12.0%
	Nuk ka përgjigje	1.6%	.0%	11.8%	2.1%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

25-30	Marrëdhëniet janë të tensionuara dhe do vazhdojnë të jenë të tilla	14.4%	50.0%	15.4%	17.5%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por kohëve të fundit ka disa përmirësime	34.4%	12.5%	23.1%	31.7%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por janë shënuar përmirësime të konsiderueshme	18.8%	6.3%	7.7%	16.9%
	Marrëdhëniet janë shumë të tensionuara	7.5%	6.3%	7.7%	7.4%
	Marrëdhëniet nuk janë aspak të tensionuara	16.3%	6.3%	15.4%	15.3%
	Nuk e di	8.8%	12.5%	23.1%	10.1%
	Nuk ka përgjigje		6.3%	7.7%	1.1%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
31-36	Marrëdhëniet janë të tensionuara dhe do vazhdojnë të jenë të tilla	20.1%	50.0%	25.0%	22.6%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por kohëve të fundit ka disa përmirësime	25.2%	16.7%	25.0%	24.5%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por janë shënuar përmirësime të konsiderueshme	18.0%	16.7%	25.0%	18.2%
	Marrëdhëniet janë shumë të tensionuara	5.0%	8.3%	.0%	5.0%
	Marrëdhëniet nuk janë aspak të tensionuara	13.7%		12.5%	12.6%
	Nuk e di	15.8%	8.3%	12.5%	15.1%
	Nuk ka përgjigje	2.2%	.0%		1.9%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
37-45	Marrëdhëniet janë të tensionuara dhe do vazhdojnë të jenë të tilla	13.4%	50.0%	21.4%	15.3%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por kohëve të fundit ka disa përmirësime	30.8%	20.0%	35.7%	30.6%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por janë shënuar përmirësime të konsiderueshme	21.4%	10.0%	7.1%	20.2%
	Marrëdhëniet janë shumë të tensionuara	6.3%	10.0%	7.1%	6.5%
	Marrëdhëniet nuk janë aspak të tensionuara	14.3%		14.3%	13.7%
	Nuk e di	10.3%	10.0%	14.3%	10.5%
	Nuk ka përgjigje	3.6%	.0%	.0%	3.2%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
>=46	Marrëdhëniet janë të tensionuara dhe do vazhdojnë të jenë të tilla	17.0%	64.7%	17.6%	19.2%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por kohëve të fundit ka disa përmirësime	30.5%	23.5%	23.5%	29.9%
	Marrëdhëniet janë të tensionuara, por janë shënuar përmirësime të konsiderueshme	11.4%	11.8%	11.8%	11.5%
	Marrëdhëniet janë shumë të tensionuara	15.8%	.0%	23.5%	15.5%
	Marrëdhëniet nuk janë aspak të tensionuara	16.7%		17.6%	16.0%
	Nuk e di	8.2%	.0%	5.9%	7.7%
	Nuk ka përgjigje	.3%	.0%		.3%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Një e treta e shqiptarëve të Kosovës besojnë se faktori kryesor pse marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve janë të tensionuara është ndikimi i Beogradit, pastaj vjen mungesa e gatishmërisë së serbëve të Kosovës që të integrohen në shoqërinë Kosovare (që është zgjedhur si faktori kryesor nga 17% e të anketuarve shqiptarë). Edhe pakicat e tjera e kanë të njëjtin mendim si shqiptarët rreth asaj se cilët janë faktorët kryesorë pse marrëdhëniet ndëretnike mes shqiptarëve dhe serbëve janë të tensionuara. Rreth 23% e pakicave mendojnë se ndikimi i Beogradit është faktori

kryesor, pasuar nga rreth 23% që theksojnë mungesën e gatishmërisë së serbëve të Kosovës për tu integruar në shoqërinë kosovare si faktorin kryesor. Në anën tjetër, serbët e Kosovës besojnë se faktorët kryesorë pse marrëdhëniet me shqiptarët janë të tensionuara janë qëndrimet e udhëheqësve të shqiptarëve të Kosovës (e zgjedhur nga 41% e të anketuarve si faktori kryesor), pasuar nga përpjekjet e pamjaftueshme të shqiptarëve të Kosovës për tu kujdesur më mirë për integrimin ndëretnik (që është zgjedhur nga 17% e të anketuarve).

**Figura 3.3:** Faktorët për marrëdhëniet e tensionuara mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës – sipas përkatësisë etnike




Një tregues tjetër i rëndësishëm i marrëdhënieve ndëretnike është gatishmëria e serbëve që të punojnë dhe jetojnë bashkë me shqiptarët e Kosovës. Siç mund të shihet nga Figura 3.4, nga periudha raportuese e prillit 2010 ka pasur një rritje të rëndësishme të gatishmërisë së serbëve për të punuar me shqiptarët, për të jetuar në të njëjtin qytet dhe në të njëjtën rrugë me shqiptarët e Kosovës.

Rreth 46% e serbëve të Kosovës (për dallim nga 6% sa ishte në prillin e vitit 2010) do të pajtoheshin të punonin me shqiptarët. 45% (për dallim nga 6% në prillin e vitit 2010) e serbëve të Kosovës do të pajtoheshin të jetonin në të njëjtën rrugë me shqiptarët, pasuar nga 27% (për dallim nga 5% në prillin e vitit 2010) që do të pajtoheshin të jetonin në të njëjtën rrugë me shqiptarët e Kosovës.


Sa i përket martesave ndëretnike, rreth 4% e serbëve tregojnë gatishmëri që të martohen me shqiptarë të Kosovës. Po sikurse qëndrimet e serbëve të Kosovës, edhe qëndrimet e shqiptarëve qoftë për të jetuar në të njëjtin qytet ose në të njëjtën rrugë ose për të punuar me serbët e Kosovës kanë pësuar ndryshime të rëndësishme pozitive.

Sipas rezultateve të matjes së Pulsit Publik në nëntor të vitit 2010, rreth 48.5% (për dallim nga 36% sa ishte në prillin e vitit 2010) e shqiptarëve të Kosovës do të pajtoheshin të punonin me serbët, përderisa rreth 47% (për dallim nga 29% sa ishte në prillin e vitit 2010) e tyre do të pajtoheshin të jetonin në të njëjtin qytet me serbët dhe rreth 42% (për dallim nga 25% sa ishte në prillin e vitit 2010) do të pajtoheshin të jetonin në të njëjtën rrugë me serbët e Kosovës. Ndonëse, vetëm 5% e shqiptarëve të Kosovës do të martoheshin me serbë të Kosovës.

**Figura 3.4:** Gatishmëria e serbëve të Kosovës që të jetojnë dhe punojnë me shqiptarët e Kosovës



**Figura 3.5:** Shqiptarët e Kosovës që janë të gatshëm të jetojnë dhe punojnë me serbët e Kosovës




## KAPITULLI 4

### Siguria dhe qetësia publike dhe personale


#### Kënaqshmëria dhe marrëdhëniet me institucionet e sigurisë

Shqiptarët vazhdojnë të jenë shumë të kënaqur me punën e institucioneve të sigurisë në Kosovë. Rezultatet e matjes së Pulsit Publik në nëntor të vitit 2010 tregojnë se kënaqshmëria e tyre me KFOR-in është rritur për rreth 12 pikë të përqindjes nga prilli i vitit 2010, përderisa kënaqshmëria e tyre me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Policinë e Kosovës nuk është rritur aq shumë nga prilli 2010. Niveli i kënaqshmërisë së shqiptarëve të Kosovës me policinë e EULEX-it ka pasur një rënie të vogël prej rreth 4 pikë të përqindjes nga prilli i vitit 2010.

**Figura 4.3:** Siguria kur janë jashtë shtëpisë, sipas gjinisë




**Figura 4.1:** Përqindja e të anketuarve shqiptarë të Kosovës që janë të kënaqur me institucionet e sigurisë



Në radhët e serbëve të Kosovës, kënaqshmëria me institucionet e sigurisë në Kosovë ka pasur një rritje të konsiderueshme nga prilli i vitit 2010. Në të vërtetë, kënaqshmëria e tyre me KFOR-in, Policinë e Kosovës dhe Policinë e EULEX-it ka pasur një rritje dyshifrore të pikëve të përqindjes: 18, 14, dhe 13, respektivisht, nga prilli 2010. Kënaqshmëria e tyre me FSK-në po ashtu është rritur për gjithsej 5.5 pikë të përqindjes nga prilli i vitit 2010.


Për më tepër, nga të anketuarit u kërkua që të vlerësojnë marrëdhëniet në mes të policisë dhe komunitetit. Nga të gjithë të anketuarit, vetëm 7% mendonin se marrëdhëniet polici-komunitet janë të këqija ose shumë të këqija. Po të ndahet sipas përkatësisë etnike, këtë mendim e kishin rreth 6% e shqiptarëve të Kosovës, si dhe rreth 34% e serbëve dhe rreth 8% e të anketuarve nga pakicat e tjera.

**Figura 4.2:** Përqindja e të anketuarve serbë të Kosovës që janë të kënaqur me institucionet e sigurisë



Përveç kënaqshmërisë së tyre me institucionet kosovare të sigurisë, sondazhi po ashtu i ka pyetur të anketuarit edhe për sigurinë e tyre. Një analizë në bazë gjinore e të dhënave tregon se meshkuj ndjehen pak më të sigurt se sa femrat (60% ndaj 55%) kur janë jashtë shtëpisë. Në anën tjetër, rreth 38% e femrave krahasuar me 28% të meshkujve ndjehen të pasigurt kur janë jashtë shtëpisë.

**Figura 4.4:** Marrëdhënie të këqija ose shumë të këqija polici-komunitet, sipas përkatësisë etnike




## Diskriminimi dhe tensionet sociale

Sipas këtij sondazhi, kur u pyetën se a kanë qenë në gjashtë muajt e fundit në ndonjë situatë ku e kanë ndjerë veten të diskriminuar, shumica e të anketuarve, pavarësisht përkatësisë etnike, u përgjigjen negativisht. Prapëseprapë duket se ka një rritje mjaftë të madhe nga prilli i vitit 2010 në përqindjen e të anketuarve që mendojnë se kanë qenë të diskriminuar në gjashtë muajt e fundit. Rreth 15% e shqiptarëve të Kosovës, 22% e serbëve dhe 32% e të anketuarve nga pakicat tjera thanë se kanë pasur situata kur ata janë ndier të diskriminuar.

Sa i përket asaj se cilin institucion ose subjekt të anketuarit e konsiderojnë më së shumti përgjegjës për diskriminimin e perceptuar kundër tyre, tri institucionet kryesore që të anketuarit i zgjodhën (pavarësisht përkatësisë së tyre etnike) janë Qeveria qendrore, Komunitat dhe Policia e Kosovës.

Për shqiptarët e Kosovës që perceptojnë se kanë qenë të diskriminuar, tri institucionet kryesore janë Qeveria Qendrore, Komunitat dhe institucionet e Shëndetit Publik, ndërsa për serbët e Kosovës ato janë Policia e Kosovës, e pasuar nga një lidhje ndërmjet njëres prej pranive ndërkombëtare në Kosovë dhe Komunave.

**Figura 4.5:** Perceptimet e diskriminimit për gjashtë muajt e fundit, sipas përkatësisë etnike



Ata që janë ndier të diskriminuar raportuan për disa baza mbi të cilat kishte ndodhur diskriminimi.

Rezultatet e sondazhit të tanishëm tregojnë se tri bazat kryesore të diskriminimit janë përkatësia etnike, përkatësia politike ose mendimi ndryshe dhe gjuha.

**Tabela 4.1:** Baza për diskriminim

	Numri i përgjigjeve	Përqindja
Gjinia	19	1.5%
Mosha	20	1.5%
Gjuha	41	3.2%
Feja/ besimi	10	.8%
Përkatësia etnike/ kombëtare	71	5.5%
Përkatësia politike ose mendimi ndryshe	43	3.3%
Orientimi seksual	1	.1%
Aftësia e kufizuar	12	.9%
Të tjera: vendbanimi, statusi i refugjatit/ PZHBV-së/ emigrantit, kombësia, statusi social, statusi shëndetësor, etj.	48	3.7%
Nuk ka përgjigje	1034	79.6%
<b>Gjithsej</b>	<b>1299</b>	<b>100.0%</b>

Qeveria Qendrore, Komunitat, të pasuara nga një lidhje ndërmjet Policisë së Kosovës Gjykatave, Ndërmarrjeve Publike dhe Shëndetit Publik janë tri subjektet kryesore që janë përgjegjëse për diskriminimin kundër të anketuarve nga pakicat e tjera.

**Tabela 4.2:** Institucionet më së shumti përgjegjëse për diskriminim, sipas përkatësisë etnike

	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Komunitat	3.2%	2.8%	4.2%	3.2%
Policia e Kosovës	1.5%	4.2%	2.8%	1.7%
Gjykatat	1.3%	1.4%	2.8%	1.4%
Agjencia Kosovare e Pronës (AKP)	.3%	.0%		.2%
Një kompani publike (KEK, PTK, kompanitë e ujit, etj)	.6%	1.4%	2.8%	.8%
Një kompani private	.5%	1.4%	1.4%	.6%
Një institucion i shëndetit publik	1.6%	.0%	2.8%	1.6%
Një institucioni i shëndetësisë private		.0%	.0%	.0%
Një shkollë ose institucion akademik privat	1.1%	.0%		.9%
Një shkollë ose institucion akademik privat	.3%		.0%	.2%
Qeveria qendrore (Ministritë, shërbimet e tjera që ofrohen nga to)	3.6%	1.4%	8.5%	3.8%
Një prej pranive ndërkombëtare në Kosovë	.4%	2.8%	1.4%	.6%
Të tjera	.7%	1.4%	1.4%	.8%
Nuk e di	1.3%	1.4%	1.4%	1.3%
NA	83.6%	81.9%	70.4%	82.7%
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>


Për më tepër, tri grupet kryesore që janë perceptuar nga të anketuarit si subjekte që i nënshtrohen diskriminimit përfshijnë personat me aftësi të kufizuara, femrat dhe të moshuarit. Përderisa shqiptarët radhisin të njëjtat tri grupe të identifikuara më lartë, serbët e identifikojnë veten, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara si tri grupet më të rrezikuara nga diskriminimi. Të anketuarit e pakicave të tjera identifikojnë komunitetet RAE, femrat dhe të rinjtë si dhe personat me aftësi të kufizuara si tri grupet që më së shumti janë subjekt i diskriminimit.

**Tabela 4.3:** Grupet e perceptuara nga të anketuarit si grupet që më shumti janë subjekt i diskriminimit, sipas përkatësisë etnike

	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Gratë / vajzat	17.4%	2.7%	9.9%	16.1%
Fëmijët	8.1%	.0%	.0%	7.2%
Të rinjtë	10.6%	5.5%	8.5%	10.2%
Të moshuarit	16.3%	2.7%	7.0%	15.0%
Serbët e Kosovës	1.0%	57.5%	4.2%	4.4%
Shqiptarët e Kosovës	4.5%	.0%	.0%	4.0%
Romët, ashkalitë dhe egjiptianët	4.4%	8.2%	32.4%	6.2%
Komunitetet e tjera (përfshirë boshnjakët, turqit, goranët, mala-zeztë)	.5%		5.6%	.8%
Lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transseksualët	2.5%	1.4%	1.4%	2.4%
Personat me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe ata me çrregullime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore	20.1%	5.5%	8.5%	18.6%
Të tjerë	2.5%	1.4%	2.8%	2.4%
Nuk e di	10.0%	12.3%	14.1%	10.4%
Nuk ka përgjigje	2.0%	2.7%	5.6%	2.3%

Përveç kësaj, të anketuarve u është kërkuar që të identifikojnë se a ekzistojnë tensione sociale në mes të grupeve të caktuara shoqërore. Tri grupet kryesore me tensionet më të mëdha ndërmjet tyre, sipas rezultateve të sondazhit, janë qeveria dhe partitë opozitare, menaxhmenti dhe punëtorët, grupet e ndryshme etnike të lidhura me grupin e të pasurve dhe të varfërve. Në anën tjetër, tri grupet kryesore me më së paku tensione ose pa tensione ndërmjet tyre janë të moshuarit dhe të rinjtë, grupet e ndryshme fetare dhe meshkujt e femrat.

**Figura 4.6:** Tensionet në mes të grupeve të caktuara shoqërore








## KAPITULLI 5

### Nga: Atdhe Hetemi - Procesi i liberalizimit të vizave me BE-në

Kjo pjesë e raportit paraqet një analizë të shkurtër të perceptimeve të qytetarëve për rëndësinë, shfrytëzimin, njohuritë dhe optimizmin rreth liberalizimit të vizave, si dhe perceptimet për të mirat që do të sillte liria e lëvizjes për kosovarët. Kjo po ashtu përfshinë edhe mendimet e qytetarëve rreth arsyeve pse Kosova mbetet e përjashtuar nga procesi i liberalizimit të vizave.

#### Rëndësia dhe shfrytëzimi e vizave


**Fig. 5.1:** Mendimet për rëndësinë që ka liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës




Viti 2010 e gjen Kosovën si të vetmin vend në Rajonin e Ballkanit i cili nuk e gëzon lirinë e lëvizjes në vendet e BE-së dhe që akoma se ka filluar procesin e liberalizimit të vizave. Bazuar në rezultatet e hulumtimit të opinionit, një shumicë dërrmuese e të anketuarve (81%) mendojnë se liberalizimi i vizave është proces i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. Vetëm 9% e të gjithë të anketuarve mendojnë se ky proces ka shumë pak ose nuk ka aspak rëndësi. (Fig 5.1)

Ka dallim të qartë në mendime në mes të serbëve të Kosovës, për të cilët liberalizimi i vizave duket të jetë më pak i rëndësishëm, dhe shqiptarëve dhe të anketuarve të pakicave të tjera për të cilët kjo çështje duket të ketë rëndësi shumë të madhe (Fig 5.2). Kur kjo çështje u debatua me ekspertët e Fokus Grupit, ata erdhën në përfundim se arsyeja pse shumica e serbëve të Kosovës janë përgjigjur "nuk e di ose nuk kam përgjigje", ose që besojnë se liberalizimi i vizave për Kosovën "nuk ka aspak ose shumë pak rëndësi", është për faktin se shumica e tyre tashmë posedojnë pasaporte serbe. Kur u analizua rëndësia e liberalizimit të vizave sipas moshës dhe rinisë, u bë e qartë se kjo çështje ka rëndësi të madhe për të gjitha gjeneratat që jetojnë në Kosovë si dhe për të dy gjinitë.

**Fig. 5.2:** Mendimet për rëndësinë që ka liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës, sipas përkatësisë etnike




**Fig. 5.3:** Perceptimi i përfitimit personal nga liberalizimi i vizave, sipas përkatësisë etnike



Kur të anketuarit u pyetën se a do të “përfitojnë ata personalisht nga liberalizimi i vizave”, 65% e tyre deklaruan se ata do të përfitojnë nga ky proces, ndërsa 18% e tyre thanë se nuk përfitojnë (Fig 5.3). Vlerësohet se edhe pse ky proces ka rëndësi për 81% (Fig 5.1) të të anketuarve, jo të gjithë ata besojnë se do të përfitojnë personalisht nga kjo.


Sërish, dallim i qartë vërehet edhe kur është fjala për përkatësitë etnike, meqë të dhënat zbulojnë se 50% e serbëve të Kosovës besojnë se ata nuk do të përfitojnë nga ky proces, bashkë edhe me 33% të tjerë që u përgjigjën se “ndoshta” do të përfitojnë nga ky proces. Për dallim, shumica e shqiptarëve dhe të tjerëve mendojnë se do të përfitojnë nga ky proces. (Fig. 5.3)

**Figura 5.4:** Perceptimi i përfitimit personal nga liberalizimi i vizave, sipas arsimimit



Kur analizohen rezultatet sipas nivelit të arsimimit, përqindja e atyre që besojnë se do të përfitojnë nga liberalizimi i vizave është më e lartë në mesin e atyre me arsim fillor (63%), e pasuar nga ata me arsim të mesëm (56%) dhe me arsim të lartë (55%) (Fig. 5.4). Kur janë ndarë analizat sipas mjedisit rural/ urban ose gjinisë, nuk është vërejtur ndonjë dallim i madh në rezultate.

**Figura 5.5** Përqindja e të anketuarve që kanë aplikuar për vizë Schengen në 6 muajt e fundit




Vonesa që po vazhdon e liberalizimit të vizave me BE-në për Kosovarët konsiderohet si pengesë për lirinë e lëvizjes së tyre jashtë kufijve të Kosovës. Megjithatë, përkundër rregullave dhe rregulloreve burokratike për

marrjen e vizave në sistemin e tanishëm, çdo ditë të punës ka radhë të gjata pothuaj para të gjitha ambasadave që veprojnë në Kosovë. Ndonëse njerëzit duhet të durojnë procedurat e gjata, çmimet e larta dhe orët e bezdisshme të pritjes, vetëm gjatë 6 muajve të fundit, qytetarët e Kosovës kanë parashtruar rreth 150,000-200,000 aplikime për viza.


Figura 5.5 tregon se gjatë 6 muajve të fundit, 10% e të anketuarve kanë aplikuar për vizë Schengen. Shumica prej tyre ishin të rinj nga moshja 18 – 36 vjeçare (32%), dhe kanë pasur të kryer arsimin e lartë (15%).

**Figura 5.6:** Statusi i aplikimit për ata të anketuar që kanë aplikuar për vizë Schengen në 6 muajt e fundit



Nga ata që kanë aplikuar për viza gjatë gjashtë muajve të fundit, 50% e aplikacioneve tyre kanë qenë të suksesshme (fig 5.6).

**Figura 5.7:** Përqindja e atyre që kanë marrë viza, sipas përkatësisë etnike




Kur u analizua sipas përkatësisë etnike, u zbulua se shumica e të anketuarve që morën viza ishin serbë të Kosovës, të pasuar nga komunitetet e tjera dhe shqiptarët e Kosovës (fig 5.7).

### Njohuritë

Në rast se do të bëhej liberalizimi i vizave, duket se 78% e të anketuarve do të shfrytëzonin të drejtën e tyre dhe do të udhëtonin në vendet e Evropës për qëllime të ndryshme. Sipas rezultateve të sondazhit, 21% e tyre do të shfrytëzonin këtë për vizitë familjare, pasuar nga 19% që do të udhëtonin për arsye turistike. Përderisa për 11% e të anketuarve shkollimi do të ishte arsyeja kryesore e udhëtimit

në vendet e BE-së. Numri më i madh i respondentëve të kësaj pyetjeje (22%) nuk kishin përgjigje se për çfarë arsyeje do të shfrytëzonin lirinë e lëvizjes në BE (Fig. 5.8).

**Figura 5.8:** Qëllimi kryesor i udhëtimit në vendet evropiane




Rezultati më brengosës në këtë tabelë është ai grupi prej 15% e të anketuarve që kanë zgjedhur punësimin si arsyen e tyre kryesore për të udhëtuar në shtetet evropiane. Duke marrë parasysh se liberalizimi i vizave nuk vlen edhe për qëllime të punësimit, ky rezultat tregon se ky grup i të anketuarve nuk janë sa duhet të informuar rreth procesit të liberalizimit të vizave dhe zbatimit të tij.

Kur ky grup i të anketuarve është analizuar sipas moshës, rajonit ku jetojnë dhe nivelit të arsimit, rezultatet zbuluan se shumica e atyre që deklarojnë se qëllimi kryesor i udhëtimit të tyre në BE në rast të liberalizimit të vizave do të jetë punësimi janë të moshës 31-36 vjeçare (24%), janë nga rajoni i Prishtinës, Prizrenit dhe Mitrovicës dhe kanë të kryer arsimin e mesëm dhe fillor (36%).

Kur analizohen sipas përkatësisë etnike, të dhënat tregojnë se për shumicën e shqiptarëve vizita familjare do të ishte qëllimi kryesor i udhëtimit, pasuar nga arsyet e turizmit dhe shkollimit. Ndërsa kur është fjala për komunitetet e tjera, punësimi do të ishte arsyeja


**Figura 5.9:** Qëllimi kryesor i udhëtimit për në vendet evropiane, sipas përkatësisë etnike



Ka një ndryshim të vogël ndërmjet të anketuarve rural dhe atyre urban, ku ata që jetojnë në qytete deklaruan se do të shfrytëzonin vizat kryesisht për vizita familjare, punësim, afarizëm dhe shkollim, më shumë se ata që jetojnë në zonat rurale.

kryesore e udhëtimit në vendet e BE-së. Për shumicën e serbëve të Kosovës, vizitat turistike të pasuara nga punësimi janë arsyet kryesore të përzgjedhura (Fig. 5.9).

**Figura 5.10:** Qëllimi kryesor i udhëtimit në shtetet evropiane, sipas gjinisë




Kur analizohen sipas gjinisë, shumica e femrave do të udhëtonin për vizita familjare (27%) pasuar nga turizmi (19%). Ndërsa 14% të femrave arsyeja kryesore që ato do të udhëtonin në vendet e BE-së është shkollimi, vetëm 8% e meshkujve deklaruan se do ta bënin këtë gjë për të njëjtin qëllim, ndërsa për rreth 18% të meshkujve qëllimi kryesor i udhëtimit do të ishin vizitat turistike dhe punësimi (Fig 5.10).

Duhet cekur se Komisioni Evropian e ka theksuar se Kosova do të përfshihet në procesin liberalizimit të vizave, por vetëm kur ajo t'i plotësojë kushtet e nevojshme<sup>1</sup>. Ndonëse


mentacionit biometrik dhe të drejtat e njeriut (liria e lëvizjes brenda vendit).

Kur të anketuarit u pyetën rreth mendimit të tyre për atë se kush është përgjegjës që procesi i liberalizimit të vizave nuk ka filluar akoma, 40% e kosovarëve mendojnë se Qeveria e Kosovës dhe institucionet e tjera të saj janë përgjegjëse, pasuar nga 26% që mendojnë se përgjegjës është Bashkimi Evropian, përderisa 22% nuk kanë ndonjë mendim për këtë. Ndërkohë, shumë pak të anketuar ua ngarkuan këtë përgjegjësi qytetarëve të Kosovës, EULEX-it, UNMIK-ut ose ICO-s (Fig 5.11).

**Figura 5.11:** Kush konsiderohet përgjegjës për mos-fillimin e procesit të liberalizimit të vizave



**Figura 5.12:** Kush konsiderohet përgjegjës për mos-fillimin e procesit të liberalizimit të vizave, sipas përkatësisë etnike



nga BE-ja nuk është shpallur asnjë kusht specifik dhe as "ndonjë udhëzues" për Kosovën në lidhje me liberalizimin e vizave, por ka shumë mundësi që Kosovës do t'i duhet të plotësojë kriteret minimale si ato të vendeve fqinje, siç janë menaxhimi i kufijve, bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e drejtësisë (INTERPOL, EUPOL, etj), sigurimi i doku-


Përderisa shumica e shqiptarëve të Kosovës (45%) e konsiderojnë përgjegjëse Qeverinë e Kosovës dhe institucionet e tjera të saj, shumica e serbëve të Kosovës (36%) nuk e dinë kush është përgjegjës (Fig 6.1). Analiza tregon se nuk kishte ndryshime të mëdha në mendimet rreth përgjegjësisë sipas moshës. I vetmi ndryshim i dukshëm është se përderisa të gjitha gjenaratat përgjithësisht e konsiderojnë përgjegjëse Qe-

<sup>1</sup> Komunikatë e shtypit - Bruksel, 14 tetor 2009, Kosovo\* - Fulfilling its European Perspective, available at <http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/09/1516&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en>

verinë e Kosovës dhe Institucionet e tjera të saj (41%), rreth 34% e atyre të moshës nga 31 deri në 36 vjeçare mendojnë se BE-ja është po aq përgjegjëse sa edhe Qeveria e Kosovës që ky proces nuk ka filluar akoma, dhe rreth 26% e atyre të moshës nga 18 deri në 24 vjeçare nuk e dinë se kush është përgjegjës për vonesën në këtë proces.

Kur ndahen përgjigjet sipas përkatësisë etnike, ne shohim se shumica e serbëve të Kosovës konsiderojnë së është “gjendja ekzistuese politike” (56%), “imazhi i keq që kanë kosovarët në BE” (29%) dhe “gjendja ekzistuese ekonomike” (27%) si faktorë që e kanë lënë Kosovën jashtë dialogut për liberalizimin e vizave. Ndonëse,


**Figura 5.13:** Kush është përgjegjës për mos-fillimin e procesit të liberalizimit të vizave, sipas nivelit të shkollimit




Kur u analizua niveli i arsimimit të të anketuarve, rezultatet zbuluan se pavarësisht nivelit arsimor të tyre, shumica e kosovarëve ja atribuojnë këtë përgjegjësi Qeverisë së Kosovës dhe Institucioneve të tjera kosovare (Fig 5.13). Megjithatë, për shumicën e të anketuarve, janë dy arsye kryesore pse Kosova po lihet jashtë procesit të liberalizimit të vizave: situata e tanishme politike dhe fakti se pesë shtete anëtare të BE-së nuk e njohin shtetësinë e Kosovës.

për Komunitetet e tjera, “problemet me Serbinë” janë arsyeja kryesore pse Kosova ka mbetur jashtë. Për shqiptarët, arsyeja kryesore pse Kosova ka mbetur jashtë është për shkak të pesë vendeve të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, pasuar nga gjendja ekzistuese politike (fig. 5.14).

**Figura 5.14:** Mendimet se pse Kosova është lënë jashtë dialogut për vizat, sipas përkatësisë etnike (përgjigje të shumëfishta)




**Figura 5.15:** Mendimet se pse Kosova është lënë jashtë dialogut për vizat, sipas arsimit (përgjigje të shumëfishta)



Analiza e kësaj çështjeje sipas nivelit të arsimit tregon se për rreth 28% të atyre me arsim fillor, problemet me Serbinë shihen si arsye pse Kosova ka mbetur jashtë këtij dialogu, pasuar nga 23% të atyre që mendojnë se kjo është rezultat i gjendjes ekzistuese politike, ndërsa për shumicën e atyre me arsim të mesëm dhe terciar arsyeja kryesore është gjendja ekzistuese politike (Fig 5.15).

### Optimizmi

**Figura 5.16:** Opinionet për afatin kohor të liberalizimit të vizave, në përqindje



Gjatë sondazhit të mëparshëm në prill të vitit 2010 kur qytetarët u pyetën se cili ishte mendimi i tyre për afatin kohor për liberalizimin e vizave për Kosovën, më shumë se 53% e tyre thanë se kjo do të ndodh brenda dy viteve (Fig. 5.16<sup>2</sup>).

Por, sipas rezultateve të sondazhit të tanishëm të paraqitura në Tabelën 1, ka pasur një rënie të shkallës së optimizmit të të anketuarve. Gjashtë muaj më vonë (nëntor 2010), të anketuarit u pyetën se çka mendojnë ata sa vite duhen për liberalizimin e vizave për Kosovën, mesatarja e përgjigjeve të tyre tregon se do të


2 Kjo pyetje u analizua në hulumtimin e opinionit të bërë gjatë muajit prill 2010

duhen 4.21 vjet për liberalizimin e vizave për Kosovën (Tabela 1).

Tabela 1	Mesatarja
Sa vite mendoni se do të duhen për liberalizimin e vizave për Kosovën?	4.21


Kur u bë analiza e bazuar në gjini, ne pamë se sipas femrave do të duhen më pak se katër vite, ndërsa sipas meshkujve do të duhen rreth 4.5 vjet për liberalizimin e vizave për Kosovën. Kjo tregon se femrat janë më optimiste se meshkujt për këtë çështje (Fig 5.17).

**Figura 5.17:** Afati kohor për liberalizimin e vizave, sipas gjinisë



Ekziston një korrelacion i lartë ndërmjet atyre që kanë arsimim të lartë dhe pritjeve të tyre për liberalizim të vizave. Ata që janë më të arsimuar mendojnë se procesi i liberalizimit të vizave do të marrë më shumë kohë krahasuar me ata me më pak vite të arsimit të cilët duket të jenë më optimistë në lidhje me këtë. Sa i përket nivelit arsimor të të anketuarve, analiza zbulon se me rritjen e nivelit të arsimit, rritet edhe vlerësimi i viteve që nevojiten për procesin e liberalizimit të vizave. Në mënyrë specifike, ata me arsimim terciar janë më pesimistë krahasuar me ata që kanë arsimim të mesëm dhe fillor (fig 5.18).


**Figura 5.18:** Afati kohor për liberalizimin e vizave, sipas arsimit



Sa i përket përkatësisë etnike, serbët e Kosovës janë më pesimistët me një vlerësim mesatar prej 17.7 vitesh për liberalizimin të vizave për Kosovën, pasuar nga Pakicat e tjera 4.3, përderisa vlerësimi mesatar i shqiptarëve të Kosovës ishte 2.7 vite (Fig 5.19).

Analiza po ashtu ka zbuluar se ata që janë të pakënaqur me gjendjen politike dhe ekonomike në Kosovë janë më pesimistë në lidhje me afatin kohor të procesit të liberalizimit të vizave.

**Figure 5.19:** Timeframe of Visa liberalization, by ethnicities



### Përfundimet

Bazuar në konstatimet e sondazhit, publiku i gjerë e kupton mjaft mirë se çka nënkupton liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës. Përveç kësaj, është shumë inkurajuese që shumica e kosovarëve janë përgjigjur se ata do të shfrytëzojnë regjimin e udhëtimit pa viza për të bërë vizita familjare, për arsye turistike, mundësi për shkollim, si dhe arsye të tjera; megjithatë, është një numër mjaft i madh i të anketuarve që kanë percep-

time të gabuara rreth qëllimit të liberalizimit të vizave dhe që kanë deklaruar se do të shfrytëzonin këtë mundësi për të kërkuar punë.

Prandaj një prej sugjerimeve do të ishte që të fillohet një fushatë gjithëpërfshirëse e informimit për të informuar qytetarët e Kosovës për qëllimin e vërtetë të liberalizimit të vizave. Kjo fushatë duhet të jetë praktike dhe e drejtpërdrejtë; ajo duhet tu drejtohet të gjitha komuniteteve dhe niveleve të shoqërisë kosovare. Fokusi kryesor i saj duhet të jetë që të informojë qytetarët e Kosovës rreth të drejtave dhe përgjegjësive që vijnë me liberalizimin e vizave, në veçanti në çështjen e punësimit, shkollimit dhe migrimit.

Përqindja e aplikuesve për vizë që janë refuzuar është dekurajuese dhe kjo gjë duhet të shqyrtohet dhe debatohet më shumë në shoqërinë kosovare. Kjo duhet që të shikohet më mirë nga ambasadat përkatëse që lëshojnë viza në Kosovë si dhe arsyet për refuzimin e një numri aq të madh të kosovarëve.

Kur është fjala për akterët përgjegjës për mos fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave, është inkurajuese që qytetarët e Kosovës i konsiderojnë përgjegjëse institucionet e Kosovës, për faktin se pse dialogu nuk ka filluar akoma, qytetarët duhet gjithmonë të kërkojnë përgjegjësi nga përfaqësuesit dhe institucionet e tyre, sidoqoftë, është po ashtu e qartë se ata nuk janë aq mirë të informuar se është BE-ja dhe shtetet e saj anëtare që e fillojnë këtë dialog e jo anasjelltas.

Konstatimet po ashtu tregojnë një rritje të skepticizmit në gjysmën e dytë të vitit 2010 për atë se a do të hyjë Kosova në Listën e Bardhë të Schengenit në një të ardhme të afërt. Po ashtu është me rëndësi se vonesat në fillimin formal të dialogut të vizave për Kosovën dhe arsyeja pse Komisioni Evropian akoma nuk ia ka ofruar Kosovës Udhëzuesin, janë reflektuar në mungesën e optimizmit të kosovarëve se në një të ardhme të afërt do të përfitojnë nga udhëtimi pa viza pasi që në mesatare kosovarët mendojnë se kjo do të marrë më shumë se katër vjet.

Njësi për Hulumtime dhe Politika e UNDP-së në Kosovë ka mbajtur takimin e Fokus Grupit më 16 janar 2011 për të diskutuar konstatimet e sondazhit për matjen e Pulsit Publik.





## Vërejtjet përmblylëse nga takimi i Fokus Grupit

Derisa diskutohej për konstatimet dhe metodologjinë e sondazhit të nëntorit të vitit 2010, pjesëmarrësit e Fokus Grupit kanë bërë rekomandimet e mëposhtme në lidhje me çështjet që do të mund të pasurojnë edhe më shumë të dhënat e raporteve të Pulsit Publik:

1. Pyetjet që mund të shtohen në grupin e treguesve të demokratizimit mund të përfshijnë edhe pyetje rreth transparencës, garancive për lirinë e shprehjes dhe ato që të anketuarit i konsiderojnë si problemet kryesore të demokratizimit në Kosovë;
2. Pyetjet që duhet të shtohen në grupin e treguesve ekonomik mund të përfshijnë disa prej pyetjeve rreth mendimit të të anketuarve për stabilitetin e përgjithshëm të Kosovës dhe sa po zbatohet ligji i ri i punës;
3. Pyetjen se si e shohin qytetarët koalicionin e ri që do të krijojë Qeverinë e re të Kosovës;
4. Të shtohen pyetje që masin korrupsionin e të gjitha kompanive publike si PTK, KEK, Aeroport, Termokos, etj;
5. Të shtohen pyetje rreth mendimit të të anketuarve në lidhje me ndarjen dhe shkëmbimin e territoreve;
6. Të përfshihen më shumë pyetje për gjyqësorin dhe korrupsionin dhe pyetjet për korrupsionin dhe krimin e organizuar të bëhen më specifike;
7. Të përfshihen pyetje për nepotizmin dhe ku do të dëshironit të punoni pasi të përfundoni universitetin dhe analizoni ato sipas rajonit apo përkatësisë etnike.

Fokus Grupi po ashtu ofroi disa sugjerime që kanë të bëjnë me shkrimin e këtij raporti, siç janë:

8. Të dhënat për sigurinë dhe lirinë e lëvizjes duhet të analizohen edhe sipas rajonit;
9. Çdo pyetje duhet të analizohet nga një numër perspektivash (gjinisë, përkatësisë etnike, rajonit, etj.);

Pjesëmarrësit e Fokus Grupit kanë identifikuar shqetësimet e mëposhtme të ngritura nga të dhënat e sondazhit:

1. Rritjen e trysisë ekonomike dhe politike (gatishtësinë për të protestuar);
2. Një konstatim shumë shqetësues në kohën kur çmimet po ngrihen ndërsa pagat po mbesin ashtu si janë

3. Rënien e kënaqshmërisë për qeverinë, legjislativin dhe gjyqësorin;
4. Varfërinë/ Papunësinë, gatishtësinë për të protestuar për arsye ekonomike dhe politike – rritjen e frustrimit të qytetarëve

Ndër skenarët kyç për shqetësim të cilët i kanë diskutuar pjesëmarrësit e Fokus Grupit janë:

1. Gatishtëria më e madhe për të protestuar për arsye ekonomike dhe politike bashkë me shkallën e lartë të varfërisë dhe papunësisë janë rrezik i qartë se mund të qojnë deri te trazirat e përgjithshme;
2. Frustrimi gjithnjë e më i madh me gjendjen ekonomike dhe politike, i cili kryesisht është i drejtuar kah qeveria, ka potencial të orientohet keq drejt komuniteteve pakicë nëse ndodh edhe incidenti më i vogël.

Zhvillime të tjera që janë konsideruar si brengosëse nga pjesëmarrësit e Fokus Grupit përfshijnë:

- Frikën për rikrijimin e barrierave në mes të shqiptarëve dhe serbëve, veçanërisht duke pasur parasysh raportin e fundit të Këshillit të Evropës, i shkruar nga Dick Marty.

Sipas pjesëmarrësve të Fokus Grupit, faktorët që kanë kontribuar në rritjen e pakënaqësisë në mesin e popullatës përfshijnë:

- Problemet ekonomike dhe papunësinë;
- Raportet për krimin dhe korrupsionin dhe mungesën e ndjekjes penale të atyre që janë të përfshirë;
- Diskriminimin kundër Kosovës sa i përket bashkëpunimit rajonal;
- Përrjashtimin e Kosovës nga procesi i liberalizimit të vizave;
- Problemet me nepotizmin;
- Cilësinë e dobët të shërbimeve publike.

Sa i përket gjyqësorit, një vështrim i përgjithshëm ishte se gjendja mbetet brengosëse përkundër disa zhvillimeve pozitive gjatë viteve të kaluara. Për shembull, emërimi i gjyqtarëve është shumë i ngadalshëm dhe ka ngecur, ka mungesë të stafit mbështetës për gjyqtarët dhe në shumicën e gjykatave ka problem me mungesën e hapësirës, përderisa në përgjithësi ka mungesë të mbështetjes së përgjithshme për gjyqësorin, sundimin e ligjit dhe vendimeve që merren nga gjyqësori.



### Anketa e opinionit publik

Këto rezultate bazohen në hulumtimin e opinionit me një mostër të përfaqësimit prej 1290 qytetarëve të Kosovës mbi moshën 18 vjeçare, të të dyja gjinive, të të gjitha grupmoshave dhe nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke mbuluar si zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Mostra përfshinte 830 shqiptarë të Kosovës, 230 serbë të Kosovës dhe 230 pakica joserbe të Kosovës (gjegjesisht ajo turke, boshnjake, gorane, rome, anshkali dhe egjiptiane). Metoda e caktimit të mostrave në disa faza është shfrytëzuar për të modeluar mostrën. Ky hulumtim u krye nga ENCOMPASS (Prishtinë) prej 7 – 25 nëntor 2010.

### Llogaritja e indekseve

Indeksi i demokratizimit është një mesatare e përbërë, bazuar në vlerësimin e të anketuarve mbi se sa ata pajtohen apo nuk pajtohen lidhur me zhvillimin e proceseve të mëposhtme në Kosovë: zgjedhje të lira dhe të ndershme, Kuvendi monitoron performancën e Qeverisë, sistemi i pavarur gjyqësor, liria e shprehjes dhe e mediave, ekzistimi i shoqërisë civile e cila ka rol mbikëqyrës në Kosovë, Qeveria e bazuar në prioritetet e qytetarëve, Kushtetua dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut dhe nëse pushtetet lokale punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. Indeksi është masë e vazhdueshme e cilat mund të variojë nga 3 (maksimumi), që do të thotë se të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan plotësisht se demokratizimi është në rrugë të mbarë, deri në 0 (minimumi) që do të thotë se të gjithë pjesëmarrësit nuk pajtohen në të gjithë demokratizimi që është në rrugën e duhur.

Indeksi i pjesëmarrjes është një mesatare e përbërë, bazuar në normën e pjesëmarrjes së vetë-raportuar në aktivitete të ndryshme publike, në gjashtë muajt e fundit. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit raportojnë nëse kanë marrë pjesë në mënyrë aktive apo pasive në: diskutime publike, iniciativat qytetare, çfarëdo projekti të zbatuar nga qeveria qendrore ose lokale, në aktivitetet e OJQ-ve dhe partive politike. Indeksi është masë e vazhdueshme e cila kap vlerat në mes të 0 (minimumi) dhe 3 (maksimumi) dhe mat nivelin e pjesëmarrjes së popullsisë në jetën politike dhe qytetare në Kosovë. Indeksi i pjesëmarrjes 0 do të thotë se asnjë nga qytetarët nuk ka marrë pjesë në asnjë nga aktivitetet e lartpërmendura, ndërsa indeksi i pjesëmarrjes 3 do të thotë se ka një pjesëmarrje të plotë të publikut në të gjitha aktivitetet.

Indeksi i besimit në ekonomi është një mesatare e përbërë, e cila llogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve mbi atë se sa të favorshme, ose të pafavorshme janë kushtet ekonomike që mbizotërojnë në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, i anketuari vlerëson kushtet e mëposhtme: pritjet lidhur me të ardhurat e përgjithshme të familjes dhe kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. Vlerat mund të shkojnë nga 0 (minimum) deri në 3 (maksimumi) ku vlerat 0-1,5 tregojnë vlerësim të pafavorshëm të situatës ekonomike, ndërsa vlera 1,5-3 kryesisht tregon vlerësim të favorshëm të situatës ekonomike.

